2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Raporti vjetor i konsoliduar

Mbi monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë

JANAR-DHJETOR

Përmbajtja

1. Hyrje 3
2. Struktura 5
3. Ç'farë jane taksat dhe tatimet dhe ku dallojnë 6
4. Parimet e vendosjes së taksave dhe tarifave 7
5. Parashikimi dhe Realizimi i të Ardhurave të Bashkisë Lushnje për Vitin 2023 8
6. Të Ardhurat e Veta nga Taksat dhe Tarifat Vendore 10
7. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme 15
   a. Taksa mbi ndërtesën 16
   b. Taksa mbi tokën bujqësore 17
   c. Taksa mbi truallin 21
8. Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël 25
9. Taksa për fjetjen në hotel 27
10. Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja 29
11. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme 30
12. Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura 33
13. Taksa e tabelës dhe reklamës 35
14. Tarifa për zënien e hapsirave publike 37
15. Tarifa e Pastrimit ,Ndricimit,Gjelberimit 39
16. Tarifa e Parkimit 44
17. Të ardhura nga pagesat për Kopshte, Çerdhe e Konvikte 45
18. Renta Minerare 48
19. Shërbimi i tatimpaguesve 51
20. Kontrolli tatimor 55
21. Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore 57
22. Shpenzimet 81

HYRJE

Bashkia në kuadrin e ushtrimit të funksioneve të saj në përputhje edhe me Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" me ndryshime, Ligjin nr. 68 dt. 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", në zbatim të Udhëzimit nr. 2 datë 06.02.2012 (me ndryshime), Udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" si dhe ne zbatim të udhëzimit të ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore" Pika 14 dhe 22 , bën këtë raportim për monitorimin e zbatimt të buxhetit , per vitin 2023.

Gjatë vitit 2023 është punuar me gjithë strukturat e bashkisë për të përballuar programin e zhvillimit ekonomik vendor të planifikuar duke synuar një realizim të ardhurash dhe një përdorim me sa më efektivitet të shpenzimeve në bashki dhe në çdo njësi administrative dhe njësi vartëse.

Buxheti në vetvete është një raport balancues midis të ardhurave dhe shpenzimeve që janë përdorur në interes të qytetarëve lushnjarë dhe që kanë të bejne me punime të ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve, zgjerimin e rrjetit të ndriçimit në mjediset publike dhe mirëmbajtjen e tij, rritjen dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara, pastrimin dhe përpunimin e mbeturinave urbane, administrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore e artistike, në zhvillimin e sporteve, në shërbimin social, në mirëmbajtjen e çerdhe-kopshteve si dhe shkollave, në rehabilitimin e kanaleve dhe tregjeve publike, në mbështetjen dhe nxitjen e biznesit të qytetit.

Raporti vjetor është një pasqyrë e veprimtarisë dhe rezultateve të administratës tatimore vendore, gjatë vitit 2023, në raport me objektivat e Planit Strategjik 2018-2023 dhe planeve operacionale të vitit 2023.
Drejtoria e të Ardhurave Vendore është autoriteti shtetëror i specializuar, në varësi të Bashkisë Lushnje për krijimin, sigurimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore, si dhe taksave dhe tarifave vendore në territorine administrative të Bshkisë Lushnje.
Institucioni është i organizuar në nivel qendror me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore, përgjegjëse për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave operacionale, efikase në realizimin e misionit të institucionit. Në nivel njesi Administrative, institucioni ka 10 inspektore ne Njëssitë Administrative dhe në total në organikën e administratës tatimore vendore numërohen rreth 35 punonjës duke e renditur administratën tatimore vendore , si një nga drejtoritë ligjzbatuese më të rëndësishme në vend.
Mbledhja e të ardhurave tatimore, synohet të realizohet nëpërmjet nxitjes së përmbushjes vullnetare dhe duke kërkuar nga të gjithë taksapaguesit kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore.
Në këtë frymë, administrata tatimore nisur edhe nga praktikat e shumë vende por dhe nga praktika e administrates tatimore qendrore e cila ka ndryshuar qëndrimin e saj ndaj taksapaguesve, duke u larguar nga monitorimi i njëanshëm i përmbushjes së detyrimeve tatimore, u orientua drejt një marrëdhënieje proaktive dhe partneriteti me tatimpaguesit, duke investuar në forcimin e besimit të tatimpaguesve në

përmbushjen e nevojave të tyre. Përvoja tregon se tatimpaguesit e informuar kanë më shumë gjasë të përmbushin detyrimet e tyre në mënyrë të rregullt dhe kjo ka dhënë efekte të matshme e pozitive që do t'i gjeni në treguesit statistikorë në këtë raport.
Të dhënat e vitit 2023 tregojnë se angazhimi serioz në luftën kundër informalitetit ka dhënë efektet e pritura, që shërbejnë si indikator për rritjen e besimit dhe sigurimin e një mjedisi të shëndoshë ekonomik.

Objektivat strategjikë nga të cilat Administrata Tatimore Vendore udhëhiqet janë:

1. Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare, përmes:

- ofrimit të shërbimeve cilësore dhe reduktimit të barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore.
- rritjes së ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri.

2. Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor, sigurimeve shoqërore dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor, përmes:

- zbatimit të strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut
- përmirësimit të mëtejshëm të kontrollit tatimor dhe gjurmimit të mashtrimeve tatimore mbledhjes efikase të borxhit

3. Progresi organizativ i Administratës Tatimore Vendore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, përmes:

- aplikimit të metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një adminsitratë tatimore moderme
- zhvillimit të kapaciteteve dhe motivimit të punonjësve
- mbajtjes së proceseve optimale dhe strukturës së Administratës Tatimore
- zhvillimit dhe përmirësimit të partneriteteve
- modernizimit dhe rinovimit të infrastrukturës
- ka një rritje cilësore të komunikimit me administratën tatimore, në raport me gjetjet e vitit 2019-2022

  (transparencën, komunikimin me biznesin, aksesin në kohë dhe cilësinë e informacionit),
- Përmirësimit të komunikimit dhe shërbimet ndaj tatimpaguesve në periudhën 2023
- rritjes së cilësisë së shërbimeve elektronike të taksave që është dukshëm më e lartë në 2023, në të gjitha aspektet e vlerësuara, si : aksesi, besueshmëria dhe saktësia e përpunimit të të dhënave


- rritjes së konsiderueshme në vlerësimin për cilësinë e raportit të auditimit, si dhe sjelljen e etikën e inspektorëve
- rritjes së ndjeshme të ndërgjegjësimit të tatimpaguesve për Modulin e Analizës së Riskut dhe përzgjedhjen për inspektimet bazuar në të.

E drejta e autorit © 2023. Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Lushnje. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç për citim të fragmenteve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe kontrollimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në sistem ku mund të përdoret serish, apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjohet, incizohet apo tjera, pa lejen paraprake të Drejtorisë të Ardhurave Vendore Bashkia Lushnje.

Raporti vjetor i Drejtorisë të Ardhurave Vendore është një dokument publik i cili ngarkohet në faqen zyrtare të internetit www.bashkialushnje.gov.al

Struktura


ORGANIGRAMA Drejtoria e të Ardhurave Vendore



Ç'FARË JANE TAKSAT DHE TATIMET DHE KU DALLOJNË ?

Taksat dhe tatimet janë detyrime financiare të përcaktuara me ligj, që kontribuojnë në mbushjen e buxhetit të një shteti dhe si të tilla përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave buxhetore. Në baza të përditshme, fjala 'tatim' përdoret si sinonim i fjalës 'taksë' apo anasjelltas. Një praktikë e tillë nuk haset vetëm në diskursin e popullit, por edhe në atë të medias, shoqërisë civile e politikanëve. Në të vërtetë, në biseda të përditshme, këto dy terma mund t'i përdorim sikur të kishin kuptimin e njëjtë, mirëpo dallimi mes tyre është substancial. Taksat dhe tatimet dallojnë për nga përkufizimi, qëllimi dhe natyra e tyre.

Figura 1. Dallimi midis takses dhe tarifes



PARIMET E VENDOSJES SË TAKSAVE DHE TARIFAVE

Para se të hyjmë më thellë në shtjellimin e problemit kyç që adreson kjo analizë, po paraqesim një pasqyrë më të qartë për të kuptuar më mirë natyrën e taksave dhe tarifave vendore. Në parim, tatimet /taksat dhe tarifat ndahen në dy grupe, në ato direkte, ku përfshihen tatimi në të ardhura, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel ,taksa e nderteses, etj., dhe ato indirekte, të cilat i paguajmë përmes ofrimit të shërbimeve publike të ndryshme. Në këtë kategori bëjnë pjesë, tarifa e pastrimit,ndrcimit,gjelberimit, tarifa e zenies se hapesires publike, tarifa per parkim, etj. Niveli i taksave dhe tarifave vendore mund të përcaktohet në disa mënyra, duke marrë parasysh parimet e më poshtëme:




Figura 2. Parimet per vendosjen e taksave dhe tarifave

I .Parashikimi dhe Realizimi i të Ardhurave të Bashkisë Lushnje për Vitin 2023

Parashikimi i të ardhurave për vitin 2023 është mbështetur në realizimin e pritshëm të të ardhurave të viteve të mëparshme dhe njëkohësisht në paketat fiskale të hartuar nga Bashkia Lushnje, tarifat e miratuara gjatë vitit 2023, nga Këshilli i Bashkisë Lushnje, dhe rritja e performancës në mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.

Gjithashtu rritja e të ardhurave të parashikuara në vitin 2023, është mbështetur, kryesisht në zgjerimin e bazës së tatimpaguesve në gjithë territorin e Bashkisë Lushnje, në punën e madhe dhe zbatimin me rigorozitet të procedurave për mbledhjen e taksave nga çdo qytetar apo biznes dhe jo në rritjen e vlerës së taksave dhe tarifave.

Hartimi i programit mbi planifikimin e të ardhurave , mbështetet në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore i ndryshur,ligjin nr. 139/2015 "Për veteqeverisjen vendore "ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", dhe në Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor. Objektivat e çdo programi janë përcaktuar nga Njësitë Shpenzuese të përfshira, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse. Baza mbi të cilën janë përcaktuar sektorët parësorë të zhvillimit dhe identifikimit të prioriteteve të shpërndarjes së burimeve për periudhën 2023 janë kërkesat e qytetarëve, të shprehura përmes diskutimeve publike me qytetarët e të 10 njësive administrative dhe programi qeverisës i Kryetarit të Bashkisë për vitet 2023-2027.

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë e Lushnjes është mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, informacion i përfituar nga programi i taksave vendore, në ecurinë e realizimit të tyre në vite si dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke u mbështetur në aktet ligjore për to. Si rrjedhim i reformës territoriale dhe të ardhurave të trashëguara nga njësitë vendore të shkrira si dhe ndryshimeve ligjore për taksat vendore, të ardhurat e Bashkisë së Lushnjes për vitin 2023, paraqiten me një rritje të ndjeshme në krahasim me periudhat e mëparshme, Këto parashikime mbështeten në llogaritjet e përgjithshme që janë të lidhura ngushtë me masat, që pritet të ndërmerren nga administrata tatimore në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Bashkisë por dhe jashtë saj, për realizimin e parashikimeve të pretenduara të të ardhurave. Parashikimi i të ardhurave për këtë periudh reflekton dhe ndryshimet në paketën fiskale si dhe parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve.

Në këtë parashikim janë marrë në konsideratë:

1. Rritja të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja);
2. Lehtësimi i proçedurave në marrëdhënie me subjektet;
3. Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo tatim/takse /tarife, për faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve;
4. Ritja e pajtueshmërisë vullnetare

5. Rritja e performancës së mbledhjes të të ardhurave tatimore mbi parashikimet aktuale;
6. Përmirësimi dhe sigurimi i shërbimeve më të mira për tatimpaguesit;
7. Reforma kundër informalitetit dhe fokusi në mirë-administrim;
8. Trajnimi i vazhdueshëm për nënpunësit e të gjitha niveleve;
9. përmirësimi i administrimit të mbledhjes së tatimeve me efekte rritjen e tyre
10. efektet e paketës fiskale për vitin 2023

Ndryshimet ligjore të fund-vitit 2017 në sistemin fiskal, nga njëra anë, synuan të lehtësojnë biznesin dhe, nga ana tjetër, rregullojnë dhe normalizojnë situatën në shumë sektorë të ekonomisë lokale. Këto ndryshime, njëkohësisht, rrisin të ardhurat e Bashkisë Lushnje.

Të ardhurat e buxhetit të njësive të qeverisjes vendore përbëhen nga:

Burimet e financimit të buxhetit për Bashkise Lushnje, përbëhen nga:


I. Të ardhurat e veta:
   a) Të ardhurat tatimore;
   b) Të ardhurat jotatimore;
   c) Të ardhurat nga njësitë e varësisë;
II. Transferta e pakushtëzuar.
III. Transferta e kushtëzuar;

Ndërkoh për vitin 2023, parashikimi i te ardhurave dhe realizimi, është si me poshtë:


Nr.	INSTITUCIONI	Plani Vjetor 2023	Totali i të ardhurave 2023		%
			Plan	Fakt	
1	Të ardhura e vitit 2023	**613,300**	613,300	482,264	*78.6*
2	Të ardhurat e trashëguara v.2022	**169,440**	169,440	208,728	*123.2*
3	Transf. pa kushtëzuar v.2023	**500,773**	500,773	500,773	*100.0*
4	Transf pak.sektoriale v.2023	**279,784**	279,784	279,784	*100.0*
5	Transf pak.sektoriale shtesa	**103,894**	103,894	103,894	*100.0*
	SHUMA	**1,667,190**	**1,667,190**	**1,575,443**	***94.5***

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme, në total të ardhurat e bashkisë për vitin 2023 janë realizuar 1,575,443,000 lekë nga 1,667,190,000 lekë të planifikuara ose 94.5% e planit vjetor.

NGA VIJNË PARATË E BUXHETIT ?



Të Ardhurat e Veta nga Taksat dhe Tarifat Vendore




Realizimi i transfertës së pakushtëzuar dhe i transfertës specifike të marra së bashku është në nivelet 100 %. Një pjesë e tyre që ka qenë gjendje në llogaritë e veçanta të shpenzimeve është trashëguar për në fillimin e vitit 2024. Plani i transfertave (grandeve) është i ndarë në tremujorë, aq sa është dhe përcaktimi në mbështetje të Udhëzimit Plotësues përkatës, sipas të cilit çeljet e transfertave të pakushtëzuara dhe të transfertës së pakushtëzuar sektoriale bëhen 30% në tremujorin e parë, 25% në tremujorin e dytë, 23% në tremujorin e tretë dhe 22% e vlerës së përgjithshme çelet në tremujorin e katërt.

Realizimi i të ardhurave të trashëguara është në vlerën e 208,728,000lekë nga 169,440,000 lekë që janë të planifikuara për vitin 2023. Kjo është një vlerë që përcaktohet në mënyrë të përafërt dhe ndikohet nga ecuria e likuidimeve në fund të vitit. Për këtë vlerë bëhet edhe rakordim me Degën e Thesarit.

Analiza për realizimin e hollësishëm të ardhurave të vetë bashkisë është bërë në vazhdim.


Në total të ardhurat që i takojnë sipas planifikimit vetëm Bashkisë:

- Viti 2023 janë realizuar 471,778,000 lekë nga 586,560,000 lekë të planifikuara ose 80.48%.
- Viti 2022 janë realizuar 421,316,000 lekë nga 584,160,000 lekë të planifikuara ose 72.12%.
- Viti 2021 ishte me realizim 403,795,000 lekë nga 584,007,000 lekë të planifikuara ose 69,1%.
- Viti 2020 ishte me realizim 401,805,000 lekë nga 590,367,000 lekë të planifikuara ose 68.1%.
- Viti 2019 ky realizim ishte 382,341,000 lekë nga 585,823,000 lekë të planifikuara ose 65.3 %




Të ardhurat e realizuara nga Qendra e Arsimit për kopshte, çerdhe, konvikte, etj.

- Për vitin 2023 janë realizuar në masën 9,664,000 lekë nga 12,240,000 lekë të planifikuara ose 78.95%,
- Për vitin 2022 janë realizuar në masën 9,489,000 lekë, nga 12,240,000 lekë të planifikuara ose 77.52 %.
- Për vitin 2021 janë realizuar në masën 8,923,000 lekë nga 12,220,000 lekë të planifikuara ose 73 %.
- Për vitin 2020 realizimi ishte 6,053,000 lekë nga 12,200,000 lekë të planifikuara ose 49.6 %, (vit i cili pati ndikim të madh nga pandemia).




Të ardhurat e realizuara nga Ndërmarrja e Pasurisë Publike:

- Për vitin 2023 janë realizuar 6,299,000 lekë nga 13,000,000 lekë të planifikuara ose 48.45%.
- Për vitin 2022 realizimi ishte 6,539,000 lekë nga 13,000,000 lekë të planifikuara ose 50.3%.
- Për vitin 2021 realizimi ishte 6,526,000 lekë nga 13,000,000 lekë të planifikuara ose 50.2 %.
- Për vitin 2020 realizimi ishte 5,891,000 lekë nga 13,000,000 lekë të planifikuara ose 45.3 %.



Të ardhurat e realizuara nga Qendra e Kulturës:

- Viti 2023 janë realizuar 50,000 lekë nga 1,500,000 lekë ose 3.33%,
- Për vitin 2022 janë realizuar vetëm 28,000 lekë nga 1,500,000 lekë të planifikuara ose 1.86 %,
- Për vitin 2021, ku realizimi ishte 6,000 lekë nga 1,500,000 lekë të planifikuara.



Realizimi më i detajuar i të ardhurave vendore paraqitet në tabelën në vijim.

PARASHIKIMI DHE REALIZIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2023

në '000 lekë

Nr.	Lloji i të Ardhurave	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023		
		Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Plan	Fakt	
	Bashkia															
I	**Të ardhura të taksueshme**															
1	Taksë mbi ndërtesat	13,890	16,516	17,795	33,853	53,471	69,795	66,284	58,152	83,250	72,181	69,009	68,589	97,000	80,272	
2	Taksë mbi tokën bujqësore	1,968	3,679	3,764	6,424	46,241	66,464	46,964	54,049	44,078	58,439	58,047	45,904	100,000	60,589	
3	Taksë mbi truallin	0	0	0	0	0	8,705	10,392	11,030	15,398	17,052	18,695	19,774	20,400	22,106	
4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	57,257	17,404	1,104	14,806	20,021	28,429	55,339	47,763	27,483	49,094	43,343	46,754	70,300	35,819	
4.1	ALUIZNI	1,934	1,827	8,040	0	0		0	-		0	0	0	0	0	
5	Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier	27	61	75	45	70	80	126	221	348	149	313	356	180	535	
6	Taksa vendore e tabeles	170	221	155	238	1,142	6,601	7,689	11,087	10,908	9,773	8,144	9,536	10,000	13,064	
7	Taksë mbi veprimtarinë e Bizn. Vogël (Tatim i thjeshtuar mbi fitimin)	38,400	40,771	33,319	31,766	53,663	11,166	5,030	3,376	3,529	4,562	3,226	862	0	661	
8	Tarifa për leje transporti	1,516	1,587	1,606	2,213	2,362	1,896	5,375	1,521	6,627	3,214	1,923	6,747	5,030	3,274	
9	Tarifa për dhënie license								5,100	373						
	Shuma I	**115,162**	**82,066**	**65,858**	**89,345**	**176,970**	**193,136**	**197,199**	**192,299**	**191,995**	**214,464**	**202,700**	**198,523**	**302,910**	**216,320**	
II	**Taksa të ndara**															
1	Taksa e kalimit të drejt së pronësisë të pas. paluajt	8,045	7,676	6,937	4,228	4,137	4,069	1,820	4,800	7,898	2,722	5,519	6,840	10,000	7,051	
2	Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura	11,457	16,637	13,454	10,739	20,236	20,882	21,831	30,240	35,501	37,864	40,471	44,335	36,000	49,273	
3	Renta minerare					7,635	5,103	4,156	4,358	5,371	3,109	5,405	6,886	6,900	5,800	
4	Nga tatimi mbi të ardhurat personale								-	-	17695	23,411	26,476	12,000	33,914	
5	Transfertë nga MIE											355				
	Shuma II	**19,502**	**24,313**	**20,391**	**14,967**	**32,008**	**30,054**	**27,807**	**39,398**	**48,770**	**61,390**	**75,162**	**84,537**	**64,900**	**96,038**	
III	**Tarifa**															
1	Tarifë (për qëllime biznesi) për zënien dhe përdorimin e hapësirave publike	349	1,403	1,152	992	1,753	1,323	1,222	1,093	1,702	1,101	1,662	1,336	1,500	2,195	
2	Tarifë për reklama	4,087	4,945	4,694	4,308	3,873	5,413	4,761	169	-	-	-	-			
3	Tarifë për parkim (për zënien dhe përdorimin e hapësirave publike për parkim)	2,255	2,248	2,584	3,094	2,446	3,020	3,028	3,667	5,692	5,117	5,362	6,230	8,000	6,741	
4	Tarifa pastrimi, higjene dhe ndriçimi	14,819	28,883	29,983	40,348	50,019	81,335	77,023	93,111	100,885	95,631	91,934	91,015	110,000	104,357	
5	Tarifë për therjen e bagetive	352	549	628	647	902	607	574	1,263	1,051	711	669	-	0	0	
6	Tarifë për lëshime vërtetime								1,573	1,208	750	1,172	634	4,000	569	


	Shuma III	**21,862**	**38,028**	**39,041**	**49,389**	**58,993**	**91,698**	**86,608**	**100,876**	**110,538**	**103,310**	**100,798**	**99,215**	**123,500**	**113,862**	
IV	**Të ardhura të tjera**															
1	Qera ndërtese	1,138	1,131	1,307	1,264	1,172	1,173	1,161	1,350	6,926	8,033	8,304	8,262	8,250	7,727	
2	Qera toke bujqësore & asete					459	438	358	485	891	1122	1,485	627	5,190	875	
3	Shitje trualli + Qera Trualli	2,957									0	0	-			
	Shuma IV	**4,095**	**1,131**	**1,307**	**1,264**	**1,631**	**1,611**	**1,519**	**1,835**	**7,818**	**9,155**	**9,788**	**8,888**	**13,440**	**8,602**	
V	**Taksa, tarifa & të ardhura të tjera**															
1	Të tjera	25							22,130	15,041	12,311	14,336	29,315	80,810	36,434	
2	Të ardhura me destinacion (pullat gj.civile)								8	1	1	0.9	-	0	0	
3	Të ardhura nga shërbimi MZSH								1,916	1,179	1,174	908	837	1,000	524	
4	Te Ardhura te Tjera Administrative + Gjoba	2,408	2,666	23,624	10,131	30,225	23,461	20,459		7,000	-	-	-			
5	Sponsorizime											99	-			
	Shuma V	**2,433**	**2,666**	**23,624**	**10,131**	**30,225**	**23,461**	**20,459**	**23,754**	**23,221**	**13,486**	**15,347**	**30,152**	**81,810**	**36,958**	
	Bashkia (I+II+III+IV+V)	**163,054**	**148,204**	**150,221**	**165,096**	**299,827**	**339,960**	**333,592**	**358,162**	**382,341**	**401,805**	**403,795**	**421,316**	**586,560**	**471,780**	
	Qendra Arsimit	-	-	-	-	-	**10,051**	**9,678**	**9,281**	**9,401**	**6,053**	**8,923**	**9,489**	**12,240**	**9,664**	
1	Të prindërve për kopshtet e fëmijëve+ cerdheve						8,873	8,758	8,999	9,261	6,025	8,870	9,332	11,840	9,529	
2	Të prindërve për çerdhet e fëmijëve						899	631	-		11	-	-			
3	Të prindërve për konvikte						279	289	271	123	3	43	7	300	132	
4	Të tjera								11	17	14	9	-	100	3	
	Ndërmarrja e Pasurise Publike	**9,323**	**11,083**	**8,864**	**10,004**	**10,739**	**12,367**	**4,976**	**3,141**	**4,158**	**5,891**	**6,526**	**6,539**	**13,000**	**6,299**	
1	Të ardhura nga vaditja	-	-	-	-	-	1,609	1,346	1,752	1,976	2,703	2,782	2,682	10,000	1,972	
2	Të prindërve për kopshtet e fëmijëve	7,464	7,141	7,111	7,743	7,519	-	-	1,389	-	3188	3,744	-			
	Të prindërve për çerdhet e fëmijëve	543	556	624	848	856	-	-	-	-	-	-	-			
	Të prindërve për konvikte	301	310	103	208	266	-	-	-	-	-	-	-			
	Të tjera	1,015	3,076	1,026	1,205	1,738	1,394	3,630	-	2,182	-	-	-	3000	4327	
	Të Ardhura nga Ujesjellesi Fshat	-	-	-	-	360	9,364	-	-	-	-	-	-			
											-	-	-			
	Qendra Kulturore & Klubi i Sportit	**167**	**2,548**	**798**	**444**	**89**	**104**	**138**	**44**	**73**	**25**	**6**	**28**	**1,500**	**50**	
1	Te ardhura nga biletat	160	2,414	641	194			0	-	-	-	-	-			
2	Qera Ambiente + te tjera te ardhura	7	134	157	250	89	104	138	44	-	-	-	-			

	TOTALI (Bashki+3 nd/jet)	172,544	161,835	159,883	175,544	310,655	362,482	348,384	370,927	395,974	413,773	419,249	437,372	613,300	487,791	
		59%	39.40%	40%	55.4	59.5	58.3	55.6	62.17		67.1	68.5		80%		

Shënim : **Vlera 69,307,466.51 lekë është arkëtuar nga UKL për periudhën Janar-Dhjetor 2022, si dhe Nëntor – Dhjetor 2023 ,por nuk eshte kryer kalimi i shumes per llogari te Bashkise Lushnje deri më atë 31.12.2023*



Grafiku 1. Paraqitja grafike e taksave dhe tarifave vendore nder vite



-Në total, për vitin 2023, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Lushnje përfshirë dhe Njësitë administrative Kolonjë, Bubullim, Krutje, Allkaj, Fiershegan, Karbunarë e vogel, Hysgjokaj, Ballagat, Golem, Dushk, është realizuar në shumën 487,791,000 lekë kundrejt planit vjetor prej *610,900,000* lekë ose 80 %.

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2023 eshte realizuar në masën 80 %, me një mosrealizim në shumën 123,109,000 lekë. Peshën më të madhe në këtë mosrealizim kryesisht e kanë Taksa mbi token Bujqesore,Taksa e ndikimit në Infrastrukturë, Taksa e ndërtesës,Taksa e kalimit të drejtës së pronesise etj..Te dhenat e mesiperme flasin për një nivel në rritje e të ardhurave tatimore për vitin 2023, në krahasim me vitet 2011-2022.

Sikurse mund të vihet re, të ardhura të taksueshme të marra së bashku këto përbëjnë 309,084,000 ose 63.3% të të ardhurave në total.





Figura 3. Procesi i grumbullimit dhe shperndarjes se taksave dhe tarifave vendore ne Bashkine Lushnje


Grafiku A1. *Pesha specifike e e taksave dhe tarifave vendor në vitin 2023.*



Për të kuptuar më mirë strukturën e të ardhurave të veta dhe performancën e bashkise në vite, para dhe pas reformës administrative dhe territoriale, mund ti referohemi grafikut 1. Kontribuuesit kryesorë të rritjes së të ardhurave vendore janë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, tarifat e shërbimeve të largimit të mbetjeve, ndriçimit publik dhe gjelbërimit, tarifat administrative dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë .

- TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.

Grafiku A:Realizimi I taksës mbi pasurinë e paluajtshme (2011-2023)



	Taksë Ndertese	Taksë Ndertese (Agjenti UKL)	Taksë Trualli (Agjenti UKL)2	Takse tokes Bujqesore	Taksa Truallit
2011	13,890,000	0	0	1,968,000	0
2012	16,516,000	0	0	3,679,000	0
2013	17,795,000	0	0	3,764,000	0
2014	33,853,000	0	0	6,424,000	0
2015	53,471,000	0	0	46,241,000	0
2016	69,795,000	0	0	66,464,000	8,705,000
2017	66,284,000	0	0	46,964,000	10,392,000
2018	58,152,000	0	0	54,049,000	11,030,000
2019	83,250,000	8,044,201	395,493.33	44,078,000	15398000
2020	72,181,000	9,654,416	455,105	58,439,000	17,052,000
2021	69,009,000	16,972,599	771,788	58,047,000	18,695,000
2022	68,589,000	24,829,215	1,144,815	45,904,000	19,774,000
2023	80,272,000	4,737,987	211,631.9	60,589,000	22,106,000

A. TAKSA MBI NDËRTESËN

Në vitin 2023, janë parashikuar te ardhura nga taksa në vlerën 97,000,000 lekë,dhë është realizuar në 80,272,000 lekë në masen 82.75% ,vlenë për tu theksuar qe me VKB Nr.117 datë 21/12/2022 UKL është caktuar agjent tatimor për arkëtimin e Taksës së Ndërtesës. Në këtë parashikim përfshihen të ardhurat nga kategoria familjare dhe kategoria e biznesit, si me poshtë:

	Parashikimi 2023
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme (NDERTES)	**97,000,000**
- Familjarët	42,083,000
- Subjektet Tregtare	54,917,000




Grafiku A2 paraqet realizimin e të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme ndertesa 2011-2023.
Të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat, të cilat zënë peshën më të rëndësishme janë rritur me rreth 13,800,599.04 lekë, në krahasim me vitin e mëparshëm.

TE ARDHURAT NDER VITE NGA TAKSA E NDERTESES

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	202
Taksë ndërtese	13,890,000	16,516,000	17,795,000	33,853,000	53,471,000	69,795,000	66,284,000	58,152,000	83,250,000	72,181,000	69,009,000	68,589,000	80,272
Agjenti tatimor													29,567,
													109,839,

**Vlera 29,567,202.3 lekë është arkëtuar nga UKL ,por nuk eshte kryer kalimi i shumes per llogari te Bashkise Lushnje deri më atë 31.12.2023*

Grafiku A2. Paraqitja grafike e takses se nderteses nder vite



Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2023 eshte realizuar 80,272,000 lekë në masën 82.75 %, me një mosrealizim në shumën 16,728,000 lekë. Peshën më të madhe në këtë mosrealizim kryesisht e kanë taksa e ndërtesës per familjaret në Njësitë Administrative,pasi nuk kanë kontratë furnizimi me UKL , si dhe ndikim në mos realizim ka patur dhe kategoria e taksapaguesve biznes, per shkak te ndryshimeve ligjore te fundvitit 2017 dhe fillim vitit 2018, ku ndryshoj dhe menyra e taksimit nga siperfaqje m^2 x cmim , ne cmim reference ose vlere prone.

Pavaresisht këtij fakti ,te dhenat e mesiperme flasin për një nivel në rritje e të ardhurave tatimore për vitin 2023, krahasuar me vitet 2011-2022.

B. TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime. Si rezultat i reformes administrativo – territoriale, Bashkise Lushnje i jane shtuar edhe siperfaqe toke bujqesore qe shtrihen ne hapsirat e njesive administrative (ish komunave) .

Në vitin 2023, janë parashikuar të ardhura nga taksa në vlerën 100,000,000 lekë,dhe është realizuar në 60,589,000 lekë në masën 60.6% me mosrealizim 39,411,000 lekë .
Taksa mbi tokën bujqësore vazhdon të zërë një peshë modeste dhe të ardhurat prej saj janë rritur me 14,685,000 lekë në krahasim me vitin 2022.
Parashikimi i të ardhurave nga taksë mbi tokën bujqesore për vitin 2023, është si më poshtë:

	Parashikimi 2023
Taksa mbi tokën Bujqësore	74,277,360
Detyrime të prapambetura	25,722,640
TOTALI	**100,000,000**

PLANIFIKIMI I TAKSES SE TOKES NE BAZE TE /Ha


	Sip/ HA Lushnje	*Sip/ HA Nj.Allkaj*	*Sip/ HA Nj. Ballagat*				*Sip/ HA Nj.Golem*	*Sip/ HA Nj. Hysgjokaj*	*Sip/ HA Nj. Karbunar*	*Sip/ HA Nj.Krutje*	*Sip/ HA Nj. Kolonje*	*Cmimi / Ha*	*PLANI/ Lek*
Kat I-re	2.76	92.2	0	0	7	0	60	0	1	61	8.7	3920	*912,0*
Kat II-re	313.8	497.9	0	180.3	1568	72	800	9.4	2.3	1063	282.1	3430	*16,425,5*

Kat III-re	2508	1198.6	0	1787.3	261	1176	100	453.1	128.6	2146	1250	2940	***32,365,284***
Kat IV-re	625.3	0	0	849.1	687	533	700	683.6	402	382	964.3	2520	***14,682,276***
Kat V-re	125.9	0	5.9	11.3	448	244	750	50	495	46	233.8	2100	***5,060,790***
Kat VI-re	0	0	70.5	0	10	196	220	36	782.1	43	0	1680	***2,280,768***
Kat VII-re	0	0	1102.3	0	0	154	70	0	663	35	0	1260	***2,550,618***
Kat VIII-re	0	0	0	0	0		0	0	0	0	0	1260	
Kat IX-re	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1260	
											Totali		**74,277,34**

REALIZIMI NDER VITE I TAKSES SE TOKES BUJQESORE

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Taksa e tokës Bujqesore	1,968,000	3,679,000	3,764,000	6,424,000	46,241,000	66,464,000	46,964,000	54,049,000	44,078,000	58,439,000	58,047,000	45,904,000	60,589,000

Grafiku A3. *Paraqitja grafike e takses se tokës nder vite*


Takse Toke Bujqesore
+32%
më shum se viti 2022
70,000,000
60,000,000
50,000,000
40,000,000
30,000,000
20,000,000
10,000,000
0
1,968,000
3,679,000
3,764,000
6,424,000
46,241,000
66,464,000
46,964,000
54,049,000
44,078,000
58,439,000
58,047,000
45,904,000
60,589,000
2011
2012
2013
2014
2015
2016
2017
2018
2019
2020
2021
2022
2023
Takse Toke Bujqesore

Realizimi i Takses se tokes Bujqesore sipas Njesive Administrative


TAKSE TOKE

Njësia	2017	2018	2019	2020	2021	2022	PLANI	2023 Nr. Familjeve që kanë kryer pagesën	Fakti	Realizimi %
ALLKAJ	2,984,870	3,915,147	2,815,346	6,036,671	3,519,030	3,291,823	7,530,552	639	6,366,838	84.55%
BALLAGAT	1,150,273	1,989,027	1,267,764	1,535,975	1,370,176	883,205	2,046,156	197	1,062,584	51.93%
BUBULLIME	5,284,958	6,525,814	5,455,026	7,618,955	6,331,886	5,743,379	10,820,424	825	6,315,630	58.37%
DUSHK	4,487,709	5,978,163	4,593,928	5,963,926	9,887,921	6,090,303	11,931,600	1017	7,677,512	64.35%
FIER SHEGAN	3,853,905	3,987,097	2,597,490	2,814,898	2,123,452	6,222,889	8,190,528	647	5,579,595	68.12%
GOLEM	5,429,427	6,849,623	4,372,659	7,275,716	7,174,649	4,814,146	9,519,048	773	5,369,457	56.41%
HYSGJOKAJ	2,672,869	1,779,452	1,042,750	2,066,225	1,645,083	1,532,953	4,379,172	200	1,903,474	43.47%
KARBUNARE E VOGEL	2,631,200	1,928,568	1,207,946	1,744,841	2,383,860	2,350,912	6,182,316	184	1,905,666	30.82%
KRUTJE	7,872,535	7,149,215	6,374,743	9,037,723	9,070,448	5,622,573	15,308,616	1285	11,402,268	74.48%
KOLONJE	5,287,522	7,799,048	5,688,896	5,881,507	6,377,940	4,547,562	10,229,580	829	7,531,908	73.63%
LUSHNJE	4,849,490	6,535,833	8,706,254	8,2346,61.8	8,054,166	4,762,011	13,869,024	1008	5,819,682	41.96%

Të ardhurat krahasur me vitin 2

+40.84%	•Njësia Administrative Al
+8.77%	•Njësia Administrative Ballagat
+5.29%	•Njësia Administrative Bubullim
+13.31%	•Njësia Administrative D
-7.86%	•Njësia Administrative Fiershegan
+5.84%	•Njësia Administrative Golem
+8.46%	•Njësia Administrative Hysgjokaj
-7.21%	•Njësia Administrative Karbunar e vogël
+37.75%	•Njësia Administrative K
+29.17 %	•Njësia Administrative Kolonjë

Grafiku A4. Paraqitja grafike e takses se tokes nder vite



Mosrealizimi i treguesit të taksës tokes bujqesore per vitin 2023 , ka ardhur si pasojë e mosarkëtimit të kësaj takse nga kategoria "familjarë', nga problemet ligjore te cilat ka prona (toka bujqesore) e cila ne shum zona nuk është e azhornuar dhe nuk eshte bërë menaxhimi,si dhe ndarja e pasurisë te familjaret e tjerë përfitues sipas ligjit 7501, gjithashtu Sektori i Vleresimit dhe Regjistrimit , ka kryer informatizimin e te gjithe regjistrave te taksapaguesve te tokes Bujqesore , si dhe ka perditesuar te dhenat ne regjistër duke i plotësuar me Nr.ID dhe Datelindje. Problematike eshte fakti se pas përfundimit te punes per perditesim te dhenave rreth 40 % e taksapaguesve nuk jane perditesuar te dhenat ,pasi nuk rezultojnë ne gjendje civile. Ky fakt ndikon dhe ne pengimin e marrjes se masave per mbledhjen me force te detyrimeve..

C. Taksa mbi truallin

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në m^2, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror në vit. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Në vitin 2023, janë parashikuar të ardhura nga taksa në vlerën 20,400,000 lekë,dhe është realizuar në 22,106,000 lekë në masen 108.4 %.

Mungesa e informacionit mbi të ardhurat e kësaj takse mund të lidhet me probleme të mungesës pothuajse totale të regjistrave të bazës së taksës për këtë taksë. Në këtë drejtim, një vlerësim më i thellë sugjerohet të kryhet nga autoritetet fiskale.


Parashikimi i të ardhurave nga taksë mbi truallin për vitin 2023, është si më poshtë:

Viti 2023

	Sip/ HA Lushnje	*Sip/ HA Nj.Allkaj*	*Sip/ HA Nj.Ballagat*	*Sip/ HA Nj.Bubullime*	*Sip/ HA Nj.Dushk*	*Sip/ HA Nj.Fiershegan*	*Sip/ HA Nj.Golem*	*Sip/ HA Nj.Hysgjokaj*	*Sip/ HA Nj.Karbunar*	*Sip/ HA Nj.Krutje*	*Sip/ HA Nj.Kolonje*	*PLANI/ Leke*
Siperfaqja	*323.83*	28.86	14.42	56	49	46.8	37.24	18	23.7	48.86	40.84	*2,831,864*
Cmimi / Ha	5600	2800	2800	2800	2800	2800	2800	2800	2800	2800	2800	
Totali	1,813,448	80,808	40,376	156,800	137,200	131,040	104,272	50,400	66,360	136,808	114,352	

**Të dhena të marra nga Drejtoria e Planifikimit të territorit në Bashkinë Lushn*

	Parashikimi 2023
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme (TRUALL)	**20,400,000**
- Familjarët	2,831,864
- Subjektet Tregtare	17,568,136




TE ARDHURAT NDER VITE NGA TAKSA MBI TRUALLIN

	2011	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**
Taksë Trualli	0	0	0	0	0	8,705,000	10,392,000	11,030,000	15,398,000	17,052,000	18,695,000	19,774,000	22,106,000
Agjenti tatimor UKL													1,356,447.07
													23,462,447.07

**Vlera 1,356,447.07 lekë është arkëtuar nga UKL ,por nuk eshte kryer kalimi i shumes per llogari te Bashkise Lushnje deri më atë 31.12.2023*

Grafiku A5. Paraqitja grafike e takses se truallit nder vite



Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2023 eshte realizuar në masën 108.4 %, me një tejkalim në shumën 1,706,000 lekë. Peshën më të madhe në këtë realizim kryesisht e kanë taksa e truallit e cila aplikohet per taksapaguesit e kategorise biznes.

Pavaresisht këtij fakti ,te dhenat e mesiperme flasin për një nivel në rritje e të ardhurave tatimore për vitin 2023, krahasuar me vitet 2011-2022.

Realizimi i Takses mbi truallin sipas Njesive Administrative (FAMILE)

Tvakse Trualli

Tvakse Trualli

Njësia	2018	2019	2020	2021	2022	PLANI	Nr.Familjeve që kanë kryer pagesën	Fakti	Realizimi %
						2023			
ALLKAJ	103,662	116,897	139,350	117,879	127,156	126,000	196	142,582	113.16%
BALLAGAT	32,131	39,030	51,332	47,091	45,747	29,676	74	39,452	132.94%
BUBULLIME	188,525	194,249	189,700	181,481	171,448	156,804	65	172,097	109.75%
DUSHK	155,040	159,806	189,418	344,322	221,413	137,196	506	254,845	185.75%
FIER SHEGAN	112,296	157,064	152,631	131,004	200,293	153,444	258	200,087	130.40%
GOLEM	237,917	157,876	191,810	182,346	157,349	104,268	147	171,762	164.73%
HYSGJOKAJ	62,041	59,783	71,564	68,247	71,585	43,404	103	72,993	168.17%
KARBUNARE E VOGEL	84,607	88,444	99,378	113,933	114,545	66,360	96	101,015	152.22%
KRUTJE	205,658	230,465	214,802	228,326	193,940	280,116	32	203,268	72.57%
KOLONJE	148,355	158,259	159,710	184,078	148,032	161,280	286	183,390	113.71%
LUSHNJE	143,967	270,710	321,757.5	343,604	288,554	1,777,440	252	332,212	18.69%

+12.24% • Njësia Administrative

-21.21% • Njësia Administrative Ballagat

+0.41% • Njësia Administrative Bubullim

+24.37% • Njësia Administrative

-0.13% • Njësia Administrative Fiershegan

+13.82% • Njësia Administrative Golem


+3.24% • Njësia Administrative Hysgjokaj

-20.39% • Njësia Administrative Karbunar e vogël

+3.33% • Njësia Administrative

+21.92% • Njësia Administrative Kolonjë

Grafiku A6. Paraqitja grafike e takses se truallit nder vite (FAMILJE)



D. Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël.


Ndryshimi i legjislacionit dhe zvogëlimi i kompetencave të bashkive mbi tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël (TTFBV) ka sjellë efekte negative për Bashkinë Lushnje, të cilat në krahasim me vitin 2015, ka humbur rreth 50,287,000 lekë nga kjo taksë, duke marrë vetëm 862,000 lekë nga 53,663,000 lekë që ishte në vitin 2015.

Çdo biznes, i cili realizon gjatë vitit një qarkullim më të vogël ose të barabartë me 14,000,000 (katërmbëdhjet milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.
Në vitin 2023, janë parashikuar te ardhura nga tatimi në vlerën 0 lekë,dhe është realizuar në 661,000.

Realizimi i të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për vitet 2011-2023, është si më poshtë:

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël	38,400,000	40,771,000	33,319,000	31,766,000	53,663,000	11,166,000	5,030,000	3,376,000	3,529,000	4,562,000	3,226,000	862,000	661,000

Grafiku A7. **Paraqitja grafike e Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël nder vite**



Në bazë të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë ï ndryshuar,Neni 15 ***<u>Zyrat tatimore të qeverisjes vendore</u>*** *.Zyrat tatimore të qeverisjes vendore funksionojnë dhe zbatojnë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave*

vendore" dhe administrojnë taksat, detyrimet tatimore dhe pagesat publike vendore, me përjashtim të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve vlerëson, mbledh, kontrollon dhe arkëton tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. (Ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, datë 28.12.2013. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, datë 30.12.2013).

UDHËZIM Nr. 32, datë 31.12.2013 PËR TATIMIN E THJESHTUAR MBI FITIMIN E BIZNESIT TË VOGËL I NDRYSHUAR , pika 10. **Administrimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin** *.Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, është e ngarkuar me administrimin e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me vlerësimin,e procedurave tatimore. Drejtoria Rajonale e Tatimeve, në funksionin e arkëtimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për llogari të bashkive/komunave, konsiderohet agjent shërbimi i këtyre të fundit. Si e tillë, DRT-ja regjistron shumat e arkëtuara në kredi të llogarisë 4481100 "Agjent shërbimesh të vitit në vazhdim" me kartela analitike për çdo bashki dhe komunë. Drejtoritë rajonale tatimore janë të ngarkuara me transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Ato krijojnë një regjistër të veçantë mbi biznesin e vogël në bazë të të dhënave që marrin nga bashkitë dhe komunat.* Si dhe **pika 11. Transferimi i të ardhurave në llogaritë e njësive të qeverisjes vendore c)** *Drejtoria rajonale tatimore pajis degën e tatimeve të bashkisë ose komunës me një listë të tatimpaguesve të regjistruar si dhe vendndodhjet e biznesit brenda juridiksionit të tyre. Kjo listë identifikon qartë emrin dhe NIPT-in e tatimpaguesit, adresën e vendndodhjes së biznesit dhe shumën e tatimit të paguar. Për të bërë transferimin, paraprakisht, kryhet procesi i rakordimit midis drejtorive rajonale tatimore me bashkitë dhe komunat, lidhur me shumat e arkëtuara sipas subjekteve tatimpaguese. Në aktrakordimin e hartuar në tri kopje, sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi, paraqitet e ndarë shuma totale e arkëtuar për bashkinë/komunën, si dhe shuma e komisionit në masën 1% e të ardhurave të arkëtuara. Drejtoritë rajonale tatimore, në bazë të aktrakordimit dhe listës së tatimpaguesve të konfirmuar nga të dyja palët, kryen transfertën nga llogaria e drejtorive rajonale "Tatime me deklarim", në llogarinë bankare të të ardhurave të degës së thesarit në rrethin përkatës, në emër të bashkisë apo komunës. Drejtoritë rajonale tatimore dërgojnë pranë degës së thesarit të rrethit përkatës një kopje të aktrakordimeve të mbajtura me secilën bashki/komunë. Në bazë të aktrakordimit përmbledhës të konfirmuar nga nëpunësi zbatues dhe autorizues i të dyja palëve, dega e thesarit të rrethit përkatës, për shumën 1% që përfiton administrata tatimore si agjent tatimor, bën rritjen e autorizuar në llogarinë e shpenzimeve 604 "Transferta në institucionet nacionale" në emër të bashkisë apo komunës përkatëse, si dhe kryen transferimin e brendshëm në sistemin financiar informatik nga bashkia/komuna në drejtorinë rajonale tatimore, duke kredituar llogarinë 7200106 "Grant nga transferimet e institucioneve lokale (bashki e komuna) tek institucionet nacionale. (Ndryshuar me Udhëzimin nr. 13, dt. 6.5.2014. Botuar ne FL.Z. nr. 65, dt. 12 maj 2014.)*

Drejtoria Rajonale Tatimore Fier si dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Lushnje çdo muaj mbajn Akt-Rakordim për shpërndarjen e Tatimit të thjeshtuar mbi fitimin ,në zbatim të Udhezimit Nr.32 datë 13.12.2013 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël"I ndryshuar ,pika 11.

E. Taksa për fjetjen në hotel.


Taksa e fjetjes në hotel, bazohet në aktivitetin si motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër me këtë destinacion. Për vitin 2023 është parashikuar rivendosja e nivelit të taksës në 70 lekë sipas përcaktimeve në ligj, kjo dhe për faktin se ulja e nivelit të taksës jo vetem që solli ulje të të ardhurave por dhe abuzime nga subjektet duke mos raportuar situatën reale të aktivitetit, kjo dhe për mungesën e kontrollit sistematik nga strukturat pergjegjese.

Në vitin 2023 janë parashikuar të ardhura nga taksë në vlerën 180,000 lekë,dhe është realizuar në 535,000 në masën 297.4 % me një tejkalim në shumen 356,000 lekë, dhe 179,000 më shum se viti 2022 .

Realizimi i të ardhurave nga **Taksa për fjetjen në hotel** për vitet 2011-2023, është si më poshtë:

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Taksa për fjetjen në hotel	27,000	61,000	75,000	45,000	70,000	80,000	126,000	221,000	348,000	149,000	313,000	356,000	535,000

Grafiku A8. Paraqitja grafike e Taksa për fjetjen në hotel nder vite



Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2023 eshte realizuar në masën 297.4 %, me një tejkalim në shumën 355,000 lekë. Sensibilizimi i taksapaguesve ,duke i rikujtuar cdo muaj afatin e deklarimit qe eshte datra 5 e cdo muaji, si dhe përgatitja e formularëve te deklarimit, ka ndikuar pozitivisht ne rritjen e te ardhurave per taksen e fjetjes ne hotel. Gjithashtu dhe kontrolli i ushtruar vazhdimisht , per uljen e informalitetit ne kete sektor.

Te dhenat e mesiperme flasin për një nivel në rritje e të ardhurave tatimore për vitin 2023, krahasuar me vitet 2011-2022.

F. Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e ndërtimit i nënshtrohen të gjitha subjektet që kerkojnë të pajisen me leje zhvillimore për ndertim objekte banimi, administrative, prodhimi, shërbimi e tjera.

Në vitin 2023 janë parashikuar të ardhura nga taksë në vlerën 70,300,000 lekë,dhe është realizuar në 35,819,000 në masën 50.95 % me një mosrealizim në shumën 34,481,000 lekë,

Referuar nivelit të takses pritshmërisë së lejeve për shqyrtim e miratim (perfshire edhe ato të depozituara prej kohesh pranë Bashkisë Lushnje nga ndërtimet informale), për vitin 2023, parashikimi nga kjo taksë, paraqitet:


	Parashikimi 2023
Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja	**70,300,000**

Në bazë të Vendimit të Keshillit Bashkiak Nr.117 datë 21/12/2021 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore.Administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundervajtjet administrative për vitin 2023", për planifikimin dhe ndjekjen e kësaj takse është ngarkuar Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashki.

Realizimi i të ardhurave nga **Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja** për vitet 2011-2023, është si më poshtë:

	2011	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	
Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja	57,257,000	17,404,000	1,104,000	14,806,000	20,021,000	28,429,000	55,339,000	47,763,000	27,483,000	49,094,000	43,343,000	46,754,000	35,8

Grafiku A9. Paraqitja grafike e Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja nder vite



Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2023 eshte realizuar në masën 50.95 %, me një mosrealizim në shumën 34,481,000 lekë.

Në zbatim të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"I ndryshuar , Neni 27 Taksa e ndikimit në infrastrukture , *pika 4. Këshilli bashkiak miraton kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve, të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës.*

G. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Në vitin 2023, janë parashikuar te ardhura nga takse ne vleren 10,000,000 lekë,dhe eshte realizuar ne 7,051,000 lekë ne masen 70.51 % ,me një mosrealizim në shumën 2,949,000 lekë.

Bazuar në këto nivele të taksës janë kryer dhe kalkukimet për parashikimin e saj për vitin 2023 , si më poshtë:


	Parashikimi 2023
Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	**10,000,000**

Realizimi i kësaj takse kryesisht nga strukturat e ASHK, agjent tatimor që përfiton edhe 3% të shumës së arketuar.

Realizimi i të ardhurave nga **Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme** për vitet 2011-2023 është si më poshtë:

	2011	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	
Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	8,045,000	7,676,000	6,937,000	4,228,000	4,137,000	4,069,000	1,820,000	4,800,000	7,898,000	2,722,000	5,519,000	6,840,000	7,0

Grafiku A10. Paraqitja grafike e Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme nder vite



Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2023 eshte realizuar në masën 70.5 %, me një mosrealizim në shumën 2,949,000 lekë.

Në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.117 datë 21.12.2022 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore.Administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundervajtjet administrative për vitin 2023", për planifikimin dhe ndjekjen e kësaj takse është ngarkuar Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashki.

Në zbatim të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"I ndryshuar , Neni 28 Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme ,pika 4. Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë ose të , në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës. ASHK Lushnje, në të gjithë praktikën e ndjekur nuk ka mbajtur Akt-Rakordim,duke qënë se është detyrë ligjore e agjentit tatimor, për arkëtimin dhe shpërndarjen e kësaj takse me Bashkinë Lushnje

H. Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura

E ardhura nga taksa, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (Drejtoria Rajonale Fier) para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore por e konvertuar në përqindje, në masën 25 % e të ardhurave vjetore mbasi është zbritur vlera e 5% që i takon agjentit tatimor DPSHTRR.

Në vitin 2023 janë parashikuar te ardhura nga takse ne vleren 36,000,000 lekë,dhe është realizuar në 49,273,000 në masën 136.87 %,me nje tejkalim ne shumen 13,273,000 lekë


	Parashikimi 2023
Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura	**36,000,000**

Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

Realizimi i të ardhurave nga **Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura** për vitet 2011-2023, është si më poshtë:

	2011	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**
Sipas nenit 88 të ligjit, paragrafi 1(**Neni 88 Autoriteti dhe kompetencat për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguar** *1. Administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencat e dhëna sipas këtij kreu për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara, për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor.), administrata tatimore ka autoritetin për të mbledhur me forcë detyrimet tatimore të papaguara, kur konstaton se tatimpaguesi nuk ka paguar në afat detyrimet e tij tatimore. Para se të filloje procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, administrata tatimore ka për detyrë të verifikojë nëse personi ndaj të cilit ajo do të veproje sipas parashikimeve të Kreut XI të ligjit për procedurat tatimore, ka apeluar detyrimin tatimor në hallkën përkatëse të apelimit tatimor, konform kërkesave të këtij ligji. Në rastet kur detyrimi tatimor nuk është apeluar ose është humbur e drejta e apelimit ose ekziston një vendim apelimi i formës së prerë, administrata tatimore është e detyruar të dërgojë në adresë të tatimpaguesit njoftimin për pagimin e detyrimeve tatimore, dhe të njoftoje atë për fillimin e procedurave te mbledhjes me force te detyrimeve tatimore.*

***

Duke pasur parasysh përmbushjen e dispozitave të pikës 88 te UMF nr. 24, kur është arritur në përfundimin se një detyrim tatimor nuk është paguar plotësisht, menjëherë njoftohet tatimpaguesi për detyrimin e papaguar, nëpërmjet postes rekomande. Njoftimi nga ana e administratës tatimore mund te behet edhe me forma te tjera te dërgimit te njoftimit, përveç postes, duke përfshire edhe dorëzimin dorazi te njoftimit kundrejt konfirmimit te marrjes se tij prej tatimpaguesit.

1. Njoftimi përmban shumën e detyrimit te papaguar,
2. Llojin e tatimit/taksës/tarifës apo

3. Sanksione qe pason ne rast te mos pagimit, fillimin e aplikimit të masave shtrënguese.

Detyrimet tatimore Vendore nxirret nga Drejtori i të Ardhurave Vendore. Njoftimi i tatimpaguesit për te paguar detyrimet tatimore, nxirret brenda 10 ditëve nga ana e administratës tatimore, dhe ky afat fillon të llogaritet nga data kur tatimpaguesi ka pasur detyrimin për ta paguar atë.

Administrata tatimore nxjerre njoftimin e kërkesës për pagim brenda tre ditëve pune nga dita e parë e punës pas përfundimit të afatit ligjor për pagimin e detyrimeve. Njoftimi vendoset ne dosjen e tatimpaguesit brenda 5 ditëve nga data e dërgimit te tij me poste rekomande apo nga data kur njoftimi i është dorëzuar dorazi tatim paguesit kundrejt konfirmimit te këtij te fundit për marrjen e tij. Me kalimin e 10 ditëve nga data e nisjes me postë të këtij njoftimi ose brenda 3 ditëve nga data e dorëzimit tatimpaguesit të njoftimit, fillon zbatimi i procedurës për mbledhjen me force te detyrimeve tatimore.

Drejtoria e të Ardhurave Vendore pasi ka konstatuar me subjekte të cilët nuk kanë paguar të plote ose kanë kryer pagesë të pjesshme të detyrimit tatimor të paraqitur pran tij ndjek procedure sipas **Nenit 89 Njoftimi dhe kërkesa për të paguar** *1. Sa herë që administrata tatimore konstaton se një tatimpagues nuk ka paguar plotësisht dhe në datën e caktuar detyrimet tatimore, administrata tatimore i dërgon, me postë rekomande, një njoftim me shkrim, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimit tatimor. Për njoftimin dhe kërkesën për të paguar zbatohen afatet dhe procedurat e parashikuara në nenin 69 të këtij ligji. 2. Nëse tatimpaguesi nuk përdor të drejtën e ankimit dhe nuk paguan detyrimin tatimor, administrata tatimore duhet ta mbledhë tatimin, duke përdorur njërën ose disa prej mënyrave, të parashikuara në këtë ligj.*

Sektori i Mbledhjes dhe menaxhimit te Borxhit tatimor prane Drejtorisë e të Ardhurave Vendore, evidenton dhe kryen proceduren e njoftimit per taksapaguesit të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore vendre për taksën/tarifat vendore (taksen e ndërtesës , truallit, taksën e tokës Bujqësore etj), në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Pamje 3. Model Njoftim dhe kerkese per te paguar

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Bashkia Lushnje

DREJTORIA E TE ARDHURAVE VENDORE

Nr. Protokolli: _____ Data: _____

Lenda: **Njoftim dhe Kërkesë për të paguar**

Subjekti: D

Perfaqesues: D

Kodi Vendor: B

NIPT: K

Lloji i aktivitetit: **MULLI BL**

Adresa: **BALLAGAT, LUSHNJE Godine 2 Kateshe**

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore,Neni 9,pika 1.3 b, dhe Ligjit Nr.9632,dt.30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore ,i ndryshuar,si dhe V.K.B Nr.102 date 22.12.2017"Për sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore,administrimin e tyre në qytetin e Lushnjes dhe Penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2018"I ndryshuar,si dhe ligjit Nr. 9920 date 19.05.2008"Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë",neni 89,pika 1 neni 114 pika 1.
Sipas të dhënave që ne disponojmë pranë Drejtorisë të Ardhurave Vendore, bazuar në të dhënat e sistemit TAIS rezulton se ju nuk keni paguar detyrimin si më poshtë:

- Detyrimi Tatimor i vitit 2019	0.00	Leke
- Detyrime Tatimore te meparshme:	55,979.25	Leke
- Gjoba:	8,447.63	Leke
TOTALI I DETYRIMIT TATIMOR :	**64,426.88**	**Leke**

Pagesa e Detyrimit Tatimor mund të kryhet në cdo Bankë të nivelit të dytë.
Po ju dërgojmë Njoftim dhe kërkes për të paguar detyrimin për taksat dhe tarifat vendore për subjektin tuaj.Nese ju nuk paguani vleren e plote të detyrimit tatimor , ndaj jush do të zbatohen procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bazë të ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar , neni 88,91, 93 "Sekuestrim dhe konfiskim i pasurisë"
Per cdo sqarim qe do f ju duhet lidhur me "Njoftim dhe kerkese per te paguar" mund te kontaktoni me inspektorin e ngarkuar per ceshtjen tuaj.

Bashkangjitur po Ju dergojme Akt- Detyrimin Tatimor sipas Taksave dhe Tarifave Vendore.

Duke Ju falenderuar per kontributin Tuaj.

Eriselda SEFA

_____

KRYETAR

FATURA E ARKETIMIT

Emri i institucionit perfitues Bashkia Lushnje

Kodi i Institucionit 2129001

Kodi i Deges se Thesarit ku vepron 0922

Me ane te kesaj fature kerkojme qe Banka Juaj te pranoje nga klienti (persona/ persona fizik/ persona juridik) arketime te te ardhurave, per llogari te institucionit tone, me emertimet, kodet dhe shumat si me poshte:

Kodi	Emertimi i detyrimit	Kodi i Llog.	Detyrimi	Likujduar	Diferenca	Afati i pageses	Barcode
DEBI00108	Debi 2011-2017 sipas fatures bashkangjitur		27,750.00	0.00	27,750.00	12/31/17	
DEBI00418	Gjobe 2017 sipas fatures bashkangjitur		5,094.00	0.00	5,094.00	12/31/17	
SP-0000058884	Taffë Gjelbërimi	7110501	1,000.00	0.00	1,000.00	06/30/18	
SP-0000058885	Taffë Noricimi	7110501	1,000.00	0.00	1,000.00	06/30/18	
SP-0000058886	Taksë Ndërtese, Njësi Adm	7020200	7,500.00	0.00	7,500.00	06/30/18	
SP-0000058887	Taffë Pastrimi	7110501	3,000.00	0.00	3,000.00	06/30/18	
SP-0000058888	Taksë ndërtese	7020200	11,729.25	0.00	11,729.25	06/30/18	
SP-0000058889	Taksë mbi Tualin	7020600	4,000.00	0.00	4,000.00	06/30/18	
SCSP00368	Kamatëvonesa	7115499	1,507.44	0.00	1,507.44	09/27/18	
SCSP01741	Kamatëvonesa	7115499	1,846.19	0.00	1,846.19	01/14/19	
Detyrimi Total:			64,426.88	0.00	64,426.88		

(Vlera e detyrimit është e vlefshme për datën e mjerrjes së Faturës për Arkëtim. Për pagesa më vonë kjo shumë mund të rritet me detyrime)

Subjekti:

NIPT:

Kodi Vendor:

Perfaqesues:

Adresa:

_____

Kons;Majlinda ARAPI

➢ **/MASAT SHTRËNGUESE**

Edhe pas dërgimit të shkrese "Njoftim dhe kërkese për të paguar" subjekti nuk ka ndërmarr masa për pagesën e detyrimit tatimore , Drejtoria e të Ardhurave Vendore fillon zbatimin e masave shtrënguese përkatësisht në zbatim të ligjit të sipërcituar Nr. 9920 date datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë „ i ndryshuar **Neni 90 Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit** ***1.*** *Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore, nëpërmjet një urdhri me shkrim, të lëshuar nga drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, apo titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore, i kërkon çdo banke, ku tatimpaguesi ka llogari në emër të vet, të bllokojë një shumë, e cila duhet të jetë më e vogla ndërmjet: (Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)*


a) shumës që kërkohet të mbahet; b) shumës, që rezulton në atë çast në llogarinë bankare të tatimpaguesit.

Shuma e bllokuar kalon për llogari të administratës tatimore sipas procedurës së përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave. (Ndryshuar me Ligj nr. 164/2014, dt. 4.12.2014. Botuar ne FLZ. Nr. 198, dt. 30.12.2014.)

Pas bllokimit të llogarive dhe informacionit të vendosur në dispozicion Drejtoria e të Ardhurave vendore për të gjithë subjektet të cilëve iu është konstatuar se kanë gjendje pozitive në llogarit bankare gjë e cila plotëson dhe detyrimin qe ka ndaj administratës tatimore , nxjerr urdhër ekzekutimi për llogarinë bankare .

Drejtoria e të Ardhruave Vendore fillon zbatimin e masave shtrënguese përkatësisht në zbatim të ligjit të sipërcituar, si dhe kërkon bashkëpunim si dhe bllokim të shërbimit ndaj subjekteve debitorë nga Drejtoritë brenda institucionit të Bashkisë si dhe nga Ndërmarrjet vartëse të Bashkisë Lushnje.

Pamje 4. Model Njoftim per urdher bllokimi te llogarive bankare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE
Sektori i Menaxhimit të Borxhit Tatimor

Nr. 920 Prot.
(Ju lutem referohuni me cdo korespondencë)

Lushnje më 2/02/2021

Lënda: **Njoftim për Vendosje Urdhër Bllokimi I llogarive bankare**

I nderuar !

Tatimpaguesi : Kujtim Qamil Çilaj
NID

Adresa : LUSHNJE
10, H. 1, ;

Administrator : Kujtim Qamil Çilaj
NID: E305080329I
Datëlindja: 08/05/1943
Adresa : LUSHNJE,MUSTAFA MATOHITI 01710154, Nd. 10, H. 1, ; LUSHNJË, KARBUNARË, 9008, LUSHNJE

1.-Ne mbeshtetje te ligjit Nr. 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise " neni 90 "Urdheri I bllokimit te llogarise bankare te tatimpaguesit " si dhe Udhezimit te Ministrise se Financave nr.24 date 02.09.2008 "Per procedurat tatimore " pika 90.
2.-Regjistrimet tona tregojnë se ju nuk keni paguar ne afatin e kerkuar ligjor detyrimet si vijon:

Lloji i Detyrimit	Vlera / lekë
Takse Toke Bujqesore	4,644

Afati i pagesës: **22/02/2021**

3.-Ju jeni njoftuar me anën e "Njoftim dhe kërkesë për te paguar", por detyrimi nuk eshte paguar ende. Keto detyrime tatimore jane subjekt i masave shtrenguese në përputhje me legjislacionin përkatës tatimor.

NJOFTIM

4.-Sektori i Menaxhimit te Borxhit Tatimor do te kryej bllokimin e llogarive bankare ne leke dhe valute te tatimpaguesve te mesipërm , si dhe te llogarive depozite dhe do te kryej brenda 3 diteve kalimin e shumë së mësipërme në llogarinë e Bashkisë Lushnje, si dhe ndalimin e transferimit jashtë shtetit të shumave te depozituara. Merrni masa për pagimin e detyrimeve tatimore brenda afatit ligjor.

Duke ju falenderuar për kontributin tuaj!

DREJTORI

Elton KORRESHI

KRYETARI

Eriselda SEFA

DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax : +3553522028
e-mail: bashkia lushnje @ yahoo.com
Web:www.bashkia lushnje.gov.al

Pamje 5. Model Urdher Bllokimi I llogarive Bankare

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE
Sektori i Menaxhimit të Borxhit Tatimor

Nr 9739 prot
(Ju lutem referohuni ne rast pergjigjeje)

Lushnje, më 11/_12_/2020

Lënda: **Urdhër bllokimi I llogarive bankare**
Për : **Raiffeisen Bank**
TIRANË

Regjistrimet tona tregojnë se tatimpaguesi i mëposhtëm nuk ka paguar në afatin e kerkuar ligjor detyrimet si vijon:

Tatimpaguesi :	Anila Qezim Seferi
NID:	I25911151N
Datëlindja:	11/09/1982
Adresa:	LUSHNJE,Topalli 01710140; Nd. 10; H. 3; Ap. 12; LUSHNJË; LUSHNJE; 9001; LUSHNJE

Lloji i Detyrimit	Vlera / lekë
Taksë toke bujqësore	-
Tarifë pastrimi dhe higjene	13,800
Taksë trualli	-
Taksë ndërtese	-
TOTAL DETYRIMI	**13,800**

Detyrimi per vitin 2020 duhej paguar deri në datë 30/10/2020

Tatimpaguesi i sipercituar i është dërguar dokumenti "Njoftim për bllokim të llogarive bankare", por ai nuk ka paguar detyrimin. Këto detyrime tashme janë subjekt i masave shtrënguese në përputhje me legjislacionin përkatës tatimor.

të 02.09.

URDHËROJ :

Bllokimin e llogarive bankare në lekë dhe valutë të tatimpaguesve të mësipërm , si dhe të llogarive depozite dhe kalimin brenda 3 ditëve nga marrja e këtij urdhri të shumës së mësipërme në llogarinë e Bashkisë Lushnje, si dhe ndalimin e transferimit jashtë shtetit të shumave të depozituara. Jemi në pritje të përgjigjes tuaj për vazhdimin e procedurave të mëtejshme.

Për veprim apo mosveprim ndaj subjekteve të mësipërme duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

Konceptoi : DEVIS SEFA

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj!

KRYETARI
Eriselda SEFA

DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE
Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax : +3553522028
e-mail:-bashkia lushnje @ yahoo.com
Web:wwwbashkia lushnje.gov.al

- **Masa e sigurimit të detyrimit tatimor**

Në zbatim të ligjit të sipërcituar Nr.9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë „ i ndryshuar

Neni 91 Masa e sigurimit të detyrimit tatimor

1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin tatimor, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit, në masën e nevojshme, për të përmbushur detyrimin tatimor të tij.

Pamje 6. Model Urdher Ekzekutimi mbi llogarine bankare

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE
Sektori i Menaxhimit të Borxhit Tatimor

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes *E-mail-bashkia lushnje @ yahoo.com*
Tel,fax :+3555522028 *Web: bashkialushnje.gov.al*

Nr _____ prot ***Lushnje, më ___/_____/2019***
(Ju lutem referohuni ne rast përgjigjie)

Lënda: **Urdhër ekzekutimi ,mbi llogarinë bankare**
Për : **Drejtorinë e përgjithshme të të gjithave bankave**
1.Raiffeisen Bank 2.Banka Kombëtare Tregtare Qënder 3.Intesa san paolo 4..Alpha Bank Albania
5.Pro Credit Bank 6. Banka e Tiranes 7. Amerikan Bank of Investments 8. Banka e Bashkuar e Shqiperise
9.Banka Credins 10. Banka Ndërkombëtare e Shqipërisë 11. Union Bank 12. Banka e Parë e Investimeve
13.Banka OTP

Për Tatimpaguesin ___ **Administrator :** ili
NIPT : K81807007F1 **Datëlindja:** ____
Aktiviteti: Organizim dhe zhvillim te lojrave te fatit **Nr.personal :** _____
Adresa : Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.2, Rruga Fuat Toptani, Godina nr.2, Zona Kadastrale nr.8190, Nr. pasurie 8/16

Në mbështetje të ligjit Nr.9920 date 19.05.2008"Per proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë " Kreu XI"Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar"si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.24 date 02.09.2008 "Për proçedurat tatimore "
Ju njoftojmë se duhet të mbani menjëhere nga llogaria e subjektit debitor:

Lloji I tatimit	Totali / Lekë
Taksa dhe Tarifa Vendore	#REF!

Në rast gjëndje monedhe të huaj të bëhet konvertimi në lekë.
Subjekti taksapagues nuk ka kryer vullnetarisht pagesën brënda afatit prej 10 ditësh pune .
Detyrimet e mbajtura të subjekteve debitore ndaj Bashkisë së Lushnje do të dërgohen me emrin

Dega e thesarit **O922**
Bashkia Lushnje **2129001**
(Fatura Bashkangjitur- kodet ekonomike)

Në rast moszbatimi, në bazë të ligjit Nr.9920 dt 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqiperisë"neni 129 "banka I paguan organit tatimor një penalitet në masën 0.2 % në ditë për shumën e detyrimit të pambajtur.

KRYETARI

Eriselda SEFA

2. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor të papaguar mund të jetë, sipas rastit, barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekore. Vendimi për të vendosur një barrë siguruese dhe/ose barrë hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit bëhet me shkrim nga drejtori i drejtorisë rajonale tatimore apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të ose titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore. 3. Para vendosjes së një barre siguruese dhe/ose barre hipotekore mbi pasurinë e tatimpaguesit, ky i fundit duhet të njoftohet me shkrim. Njoftimi duhet të përmbajë të gjithë informacionin lidhur me to.

Drejtoria e të Ardhruave Vendore ka dërguar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese për mjetet, dhe pasuritë e paluajtshme, sipas nenit 91, ë ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore Republikan e Shqipërisë"..

Pamje 7. Model per vendosje Barre Siguruese/Hipotekore mbi titujt e pronesise

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE
Sektori i Menaxhimit të Borxhit Tatimor

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel,fax :+3555522028

E-mail-bashkia lushnje @ yahoo.com
Web :bashkialushnje.gov.al

Nr ____ prot
(Ky numer referohuni ne rast korespondence)

Lushnje, më ___ /____/2019

Lënda: Njoftim për Vendosje Barre Siguruese/ Hipotekore mbi titujt e pronësisë

Tatimpaguesi : __
NIPT /NID: __ __

Administratori:
NID: __
Datëlindja: __

1 **Aksionarët:**
NID: __
Datëlindja: __

2 **Aksionarët:**
NID: __
Datëlindja: __

3 **Aksionarët:**
NID: __
Datëlindja: __

Adresa : Fier Lushnje LUSHNJE Lagjja Loni Dhamo, Rruga Vath Korreshi, godina nr 183.

1- Mbështetur në Nenin 91 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë ", Drejtoria e të Ardhurave Vendore, ka vendosur të mos lejohen të kryhen tjetersime mbi titujt e pronësisë për tatimpaguesin si më poshtë vijon :
2-Regjistrimet tona tregojnë se tatimpaguesi i sipercituar nuk ka paguar në afatin e kerkuar ligjor detyrimet si vijon:

Lloji I tatimit	Detyrimi Tatimor
Taksa dhe Tarifa Vendore	107,855
Totali	**107,855**

3-Tatimpaguesit të sipercituar i është dërguar dokumenti "Njoftim për pagimin e detyrimit", por ai nuk është paguar ende. Këto detyrime tashme janë subjekt I masave shtrënguese në përputhje me legjislacionin përkatës tatimor.

4- Ky dokument përfaqeson barrën siguruese të titujve të pronësisë ndaj tatimpaguesve debitore në favor të Bashkisë Lushnje, përfaqesuar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, nëpërmjet kësaj barre siguruese synohet të mos lejohet tjetërsimi I titujve të pronësisë përfshi dhe shitblerje aksionesh, deri në shlyrjen e detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesit debitorë, të cilët për tju shmangur detyrimeve ndaj organit tatimor , kërkojnë në institucionin tuaj tjetërsimin e titujve të pronësisë.

KRYETARI

Eriselda SEFA

Pamje 8. Model Kerkese per vendosje Barre Sigurie mbi titujt e pronesise
Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE
Sektori i Menaxhimit të Borxhit Tatimor

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes *E-mail-bashkia lushnje @ yahoo.com*
Tel,fax :+3555522028 *Web:bashkialushnje.gov.al*

Nr____ prot *Lushnje, më ___ /____/2019*
(te lutem referohuni ne rast përgjigjeje)

Lënda: Kërkesë për Vendosje Barre Sigurie mbi titujt e pronësisë
AGJENCIA S TIRANË

Tatimpaguesi : ___
NIPT /NID: ___

Fier Lushnje LUSHNJE Lagjja Loni Dhamo, Rruga Vath Korreshi, godina nr 183.

Administratori ___
NID: ___
Datëlindja:

1 **Aksionarët:** ___
NID: ___
Datëlindja:

2 **Aksionarët:** ___
NID: ___
Datëlindja:

sionarët: ___
D: ___
tëlindja:

DREJTORI

DONALD NUSHI

Adresa : Tirane Tirane TIRANE Rr."Leke Dukagjini", Pallati 11, Kati 2

1- Mbështetur në Nenin 91 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë ", Drejtoria e të Ardhurave Vendore, ka vendosur të mos lejohen të kryhen tjetersime mbi titujt e pronësisë për tatimpaguesin si më poshtë vijon :
2-Regjistrimet tona tregojnë se tatimpaguesi i sipërcituar nuk ka paguar në afatin e kerkuar ligjor detyrimet si vijon:

Llloji I tatimit	Detyrimi Tatimor
Taksa dhe Tarifa Vendore	107,855
Totali	**107,855**

3-Tatimpaguesit të sipercituar i është dërguar dokumenti "Njoftim për pagimin e detyrimit", por ai nuk është paguar ende. Këto detyrime tashme janë subjekt I masave shtrënguese në përputhje me legjislacionin përkates tatimor.

4- Ky dokument përfaqeson Barrën Siguruese në favor të Shtetit Shqipëtar,përfaqësuar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Lushnje ,mbi të gjithë pasurinë dhe të drejtat pasurore, të cilat i përkasiun këtij tatimpaguesi, lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara brenda afatit .Vendosja e kësaj barre siguruese synon të garantoj pagimin e tyre në rast mos pagimi vullnetar. Interesi përfundimtar do te pasqyrohet sipas urdher pageses. Nëse institucioni juaj disponon të dhëna të tjera mbi pasurinë e paluajtshme ,brenda 5 ditëve pune duhet të beni identifikimin e këtyre pasurive dhe vendosjen e barres siguruese në favor të administratës tatimore vendore ,deri në momentin qe detyrimi tatimor i papaguar prej tatimpaguesit të jetë shlyer.
Faleminderit për bashkëpunimin.

DREJTORI

DONALD NUSHI

KRYETARI

Eriselda SEFA

Pamje 9. Model Kerkese per vendosje Barre Sigurie mbi titujt e pronesise
Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit Transportit Rrugor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE
Sektori i Menaxhimit të Borxhit Tatimor

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes *E-mail-bashkia lushnje @ yahoo.com*
Tel,fax :+3555522028 *Web:bashkialushnje.gov.al*

Nr____ prot *Lushnje, më / /2019*
(te lutem referohuni ne rast përgjigjeje)

nda: Kërkesë për] e pronësisë
AGJENCIA S TIRANË

timpaguesi : _____
PT /NID: _____

Fier Lushnje LUSHNJE Lagjja Loni Dhamo, Rruga Vath Korreshi, godina nr 183.

Administratori ___
NID: ___
Datëlindja:

1 **Aksionarët:** ___
NID: ___
Datëlindja:

2 **Aksionarët:** ___
NID: ___
Datëlindja:

3 **Aksionarët:** _____
NID: _____
Datëlindja:

Adresa : Tirane Tirane TIRANE Rr."Leke Dukagjini", Pallati 11, Kati 2

1- Mbështetur në Nenin 91 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë ", Drejtoria e të Ardhurave Vendore, ka vendosur të lejohen të kryhen tjetersime mbi titujt e pronësisë për tatimpaguesit e mësipërm.
2-Regjistrinet tona tregojnë se tatimpaguesi i sipërcituar ka paguar detyrimet pas vendosjes së masave shtrënguese.

3- Ky dokument përfaqeson Kërkesë për Heqje Barrës Siguruese në favor të Shtetit Shqipëtar,përfaqësuar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Lushnje ,mbi të gjithë pasurinë dhe të drejtat pasurore, të cilat i përkasiun këtij tatimpaguesi, lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara brenda afatit .Vendosja e barrës siguruese synon të garantoj pagimin e detyrimit në rast mos pagimi vullnetar. Nëse institucioni juaj disponon të dhëna të tjera mbi pasurinë e paluajtshme ,brenda 5 ditëve pune duhet të beni identifikimin e këtyre pasurive dhe heqjen e barres siguruese e vendosur në favor të administratës tatimore vendore ,pasi detyrimi tatimor i tatimpaguesit është shlyer.

Faleminderit për bashkëpunimin.

DREJTORI

DONALD NUSHI

KRYETARI

Eriselda SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE
Sektori i Menaxhimit të Borxhit Tatimor

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
E-mail-bashkia lushnje @ yahoo.com
Web: bashkialushnje.gov.al

Nr ____ prot
(ju lutem referohuni ne rast përgjigje)

Lushnje, më ___ /____/26

Lënda: Kërkesë për Vendosje Barre Sigurie mbi titujt e pronësisë

QENDRA K T TIRANË

Tatimpaguesi : ___
NIPT /NID: ___

Fier Lushnje LUSHNJE Lagjja Loni Dhamo, Rruga Vath Korreshi, godina nr 183.

Administratori ka _____
NID: _____
Datëlindja:

1 **Aksionarët:** _____
NID: _____
Datëlindja:

2 **Aksionarët:** _____
NID: _____
Datëlindja:

3 **Aksionarët:** _____
NID: _____
Datëlindja:

Adresa : Tirane Tirane TIRANE Rr."Leke Dukagjini", Pallati 11, Kati 2

1- Mbështetur në Nenin 91 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë ", Drejtoria e të Ardhurave Vendore, ka vendosur të mos lejohen të kryhen tjetersime mbi titujt e pronësisë si dhe te mos lejoje te kryhet asnje veprim në QKB për tatimpaguesin si më posht vijon :
2-Regjistrimet tona tregojnë se tatimpaguesi i sipërcituar nuk ka paguar në afatin e kerkuar ligjor detyrimet si vijon:

Lloji I tatimit	Detyrimi Tatimor
Taksa dhe Tarifa Vendore	107,855
Totali	**107,855**

3-Tatimpaguesit të sipercituar i është dërguar dokumenti "Njoftim për pagimin e detyrimit", por ai nuk është paguar ende. Këto detyrime tashme janë subjekt I masave shtrënguese në përputhje me legjislacionin përkates tatimor.
4- Ky dokument përfaqeson Barrën Siguruese në favor të Shtetit Shqipëtar,përfaqësuar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Lushnje ,mbi të gjithë pasurinë dhe të drejtat pasurore, të cilat i përkasiun këtij tatimpaguesi, lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara brenda afatit .Vendosja e kësaj barre siguruese synon të garantoj pagimin e tyre në rast mos pagimi vullnetar. Interesi përfundimtar do te pasqyrohet sipas urdher pageses. Nëse institucioni juaj disponon të dhëna të tjera mbi pasurinë e paluajtshme ,brenda 5 ditëve pune duhet të beni identifikimin e këtyre pasurive dhe vendosjen e barres siguruese në favor të administratës tatimore vendore ,deri në momentin qe detyrimi tatimor i papaguar prej tatimpaguesit të jete shlyer.

Faleminderit për bashkëpunimin.

DREJTORI
Donald NUSHI

KRYETARI
Eriselda SEFA

II. SHPENZIMET

Gjatë gjithë vitit 2023 bashkia së bashku me tre njësitë shpenzuese, ka qenë e angazhuar në realizimin e detyrave të paracaktuara në drejtim të funksionimit të saj dhe të angazhimit përballë qytetarëve, për shërbime cilësore dhe në rritje.

Sipas strukturës së buxhetit të vitit 2023, transferta e pakushtëzuar është pjesë e rëndësishme e tërësisë së burimeve në përdorim. Për vitin:

- 2023 ishte 500,773,000 lekë;
- 2022 ishte 417,310,000 lekë;
- 2021 ishte 403,199,000 lekë;
- 2020 ishte 400,677,000 lekë;
- 2019 ishte 390,513,000 lekë;
- 2018 ishte 382,365,000 lekë;
- 2017 ishte 345,807,000 lekë;



Kjo transfertë ka ardhur në rritje nga viti në vit. Të ardhurat vendore të vitit 2023 janë planifikuar në masën 613,300,000 lekë. Gjatë vitit pati disa shtesa transfertë të pakushtëzuar në masën 103,894,000 lekë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, për rritjet e pagave etj. Këto vlera u paraqitën në Këshillin Bashkiak dhe u miratua për përdorim me destinacionet sipas VKM-ve apo udhëzimeve përkatëse.

Me shtimin edhe të funksioneve të reja që nga viti 2016, siç janë Sektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, arsimi (personeli arsimor në institucionet e arsimit parashkollor), punonjësit ndihmës në arsimin 9-vjeçar, punonjësit e shërbimeve mbështetëse në arsimin e mesëm, pyjet, rrugët rurale, bordi i kullimit dhe ujitjes.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale e akorduar për vitin:

- 2023 është 279,784,000 lekë;
- 2022 është 268,378,000 lekë;
- 2021 ishte 251,226,000 lekë:
- 2020 ishte 246,492,000 lekë,
- 2019 ishte 242,790,000 lekë;
- 2018 ishte 240,382,000 lekë:
- 2017 ishte 217,357,000 lekë:



Rritja ka qenë simbolike nga viti në vit. Kjo transfertë shërben për të mbuluar shpenzimet për aktivitetin e këtyre funksioneve të reja pa i hequr të drejtën bashkisë që të financojë për to.

Sipas buxhetit të miratuar për vitin 2023 bashkë me ndryshimet vjetore, nga 1,667,190,000 lekë që janë shpenzimet totale vjetore të planifikuara, 613,300,000 lekë janë planifikuar për t'u përballuar nga të ardhurat vendore ose 37% të totalit; 169,440,000 lekë mbulohen nga të ardhurat e trashëguara nga viti 2022 (për shpenzime të vetë bashkisë, për rrugët dhe për bordin e kullimit) dhe 884,450,000 lekë janë shpenzime për t'u kryer nga transferta e pakushtëzuar, transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe transferta shtuar gjatë vitit. Këto transferta mbulojnë 46.8 % të totalit të shpenzimeve për vitin 2023.

Për vitin 2023, transfertat e shtuara gjatë vitit janë në masën 103,894,000 lekë ose 6.2% e totalit të shpenzimeve të bashkisë.

Në buxhetin e bashkisë për vitin 2023 aq sa janë të ardhurat gjithsej aq janë edhe shpenzimet e parashikuara, të barabarta me 1,667,190 mijë lekë, duke qenë se buxheti vendor është një buxhet i balancuar. Ky buxhet ndiqet nga njësitë e përcaktuara në strukturë sipas ndarjeve në grupe, kapituj, programe dhe artikuj të veçantë, sipas ndarjes buxhetore.

Sipas strukturës buxhetore janë 4 njësi që mbulojnë gjithë aktivitetin e bashkisë:

1. Bashkia (Administrata dhe strukturat mbështetëse, njësitë administrative vendore, pyjet dhe PMNZSH-ja (zjarrfikësja) me 329 punonjës.
2. Ndërmarrja e Pasurisë Publike me 262 punonjës.
3. Qëndra e Kulturës dhe Klubi Shumësporteve me 53 punonjës.
4. Qëndra e Arsimit me 384 punonjës


Në total: 1028 punonjës të miratuar për vitin 2023.

Financim nga bashkia në formën e subvencionit merr edhe Klubi i Futbollit "Lushnja 1930" sipas buxhetit vjetor 2023 në vlerën prej 44,000,000 lekë. Pjesë përbërëse e numrit të punonjësve dhe fondeve të mësipërme janë dhe transfertat specifike të arsimit, shërbimit të mbrojtjes nga zjarri, pyjet, ujitja me kullimin si dhe rrugët rurale.

Sipas planit të buxhetit të vitit 2023 ndarja sipas llogarive ekonomike, me ndryshimet e bëra është:

- Pagat 645,896,000 lekë.
- Sigurimet Shoqërore Shëndetësore 110,504,000 lekë.
- Shpenzimet operative 591,951,000 lekë
- Investimet 318,839,000 lekë.

Në total buxheti: 1,667,190,0000 lekë. Në mënyrë grafike paraqitet:



Për vitin 2023, në mënyrë analitike, sipas artikujve realizimi i shpenzimeve paraqitet:

1. **Shpenzimet korrente:**

Nisur nga plani vjetor me ndryshimet e bëra, shpenzimet korrente janë shpenzime të cilat zënë pjesën më të madhe të buxhetit të bashkisë. Ato arrijnë në vlerën 1,348,351,000 lekë, ose 81 % të totalit të shpenzimeve të bashkisë për këtë vit.

Këto shpenzime përbëhen nga:

a. **Shpenzime për pagat dhe sigurimet shoqërore (Shpenzime të personelit).**

Këto shpenzime zënë 45 % të totalit të shpenzimeve të planifikuara në buxhet. Në këto shpenzime pagat për përmbushjen e funksioneve të Bashkisë dhe njësive vartëse, për vitin 2023 janë realizuar në shumën 595,511,000 lekë nga 645,896,000 lekë të planifikuara ose 95.6 %. Sigurimet Shoqërore e shëndetësore janë realizuar në shumën 99,105,000 lekë nga 110,504 mijë të planifikuara ose 89.7 %.

Bashkia më vete, ka një realizim të shpenzimeve të personelit (Paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore) në shumën 227,351,000 lekë nga 261,681,000 lekë të planifikuara ose 87 %

Ndërmarrja e Pasurisë Publike ka një realizim të shpenzimeve të personelit (Paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore) në shumën 144,475,000 lekë nga 160,916 ,000 lekë të planifikuara ose 90 %.

Qendra Kulturore dhe Klubi i Sportit ka një realizim të shpenzimeve të personelit (Paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore) në shumën 36,151,000 lekë nga 38,786,000 lekë të planifikuara ose 93%.

Qendra e Arsimit ka një realizim të shpenzimeve të personelit (Paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore) në vlerën 286,640,000 lekë nga 295,017,000 lekë të planifikuara ose 97%.

Për sa i përket peshës specifike që zënë shpenzimet e pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore kundrejt totalit të shpenzimeve të vitit, shpesh herë gjykohemi për përqindjen e lartë të saj, por kjo vjen për arsye se në transferimin e transfertave specifike gjithë punonjësit që mbulohen nga kjo transfertë erdhën pa asnjë shpenzim tjetër përveç shpenzimit të pagave e sigurimeve dhe këto shpenzime mbulojnë rreth 297 punonjës.

Në mënyrë të përmbledhur sipas njësive shpenzuese realizimi i pagave është:

në '000 lekë

Nr.	INSTITUCIONI	Plani Vjetor 2023	PAGA		%
			PLAN	FAKT	
1	Bashkia	**223,663**	223,663	194,943	*87.2*
2	Ndërmarrja P.Publike	**136,594**	136,594	123,881	*90.7*
3	Qendra Kult.& Klubi Sportit	**33,330**	33,330	30,991	*93.0*
4	Qendra Arsimit	**252,309**	252,309	245,697	*97.4*
	Gjithsej	**645,896**	**645,896**	**595,511**	***92.2***

dhe realizimi i sigurimeve shoqërore shëndetësore është:

në '000 lekë

Nr.	INSTITUCIONI	Plani Vjetor 2023	Sigurime shoq.shendetesore		%
			PLAN	FAKT	
1	Bashkia	**38,018**	38,018	32,408	*85.2*
2	Ndërmarrja P.Publike	**24,322**	24,322	20,594	*84.7*
3	Qendra Kult.& Klubi Sportit	**5,456**	5,456	5,160	*94.6*
4	Qendra Arsimit	**42,709**	42,709	40,943	*95.9*
	Gjithsej	**110,504**	**110,504**	**99,105**	***89.7***

b. Shpenzimet operative:

Këto shpenzime janë shpenzime bazë për funksionimin e shërbimeve në dobi të komunitetit. Ato zënë 36 % të totalit të shpenzimeve të planifikuara të buxhetit të vitit 2023.

Në thelb të realizimit të shpenzimeve operative është racionalizimi i shpenzimeve administrative duke vënë theksin në funksionet prioritare, si dhe në qëllimin e përdorimit të tyre për realizimin e funksioneve kryesore të Bashkisë. Përdorimi me efikasitet i këtyre shpenzimeve ka qenë dhe mbetet një prioritet i punës së drejtuesve të kësaj bashkie.

Pjesën më të madhe të këtyre shpenzimeve e përbëjnë shërbimet publike vendore si: blerje për sektorin e pastrimit dhe gjelbërimit të qytetit dhe njësive administrative, arsimi bazë para universitar dhe mirëmbajtja e rrugëve. Gjithashtu në buxhetin e shpenzimeve operative për vitin 2023 pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë shpenzimet bazë të funksionimit si: energji elektrike, ujë, shpenzime për pagesat e këshillit bashkiak dhe kryetareve të fshatrave, qiratë e objekteve dhe të të pastrehëve, fondi rezervë dhe i kontigjencës, shpronësimet, shpenzimet postare dhe të rrjetit kompjuterik, emergjencat civile etj., duke përfshirë këtu subvencionin e futbollit.

Nisur nga likuidimet e kryera në vitin 2023, për blerje mallrash dhe kryerje shërbimesh, realizimi i shpenzimeve operative sipas njësive shpenzuese paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

në '000 lekë

Nr.	INSTITUCIONI	Plani Vjetor 2023	Shpenzime operative		%
			PLAN	FAKT	
1	Bashkia	**148,858**	148,858	60,370	*40.6*
2	Ndërmarrja P.Publike	**336,886**	336,886	177,995	*52.8*
3	Qendra Kult.& Klubi Sportit	**16,212**	16,212	15,433	*95.2*
4	Qendra Arsimit	**45,995**	45,995	31,507	*68.5*
5	Subvencione futbolli	**44,000**	44,000	43,925	*99.8*
	Gjithsej	**591,951**	**591,951**	**329,231**	***55.6***

Në zërin e shpenzimeve operative është i përfshirë edhe fondi i emergjencave civile. Krahas shpenzimeve të përmendura më sipër, këtu përfshihen edhe shpenzimet për karburant, mirëmbajtje ndërtesash, mirëmbajtje rrugësh, ushqimet për kopshte, çerdhe, konvikt, siguracione mjetesh e pjesë këmbimi, kancelari, shtypshkrime, mirëmbajtje kanalesh, projekte kulturore, etj.

Ndjekja e shpenzimeve operative, bëhet në mënyrë analitike nga njësitë shpenzuese, sipas planifikimit të miratuar në buxhetin e viti 2023. Pjesën më të madhe të tyre e zënë shpenzimet për shpenzimet për pastrimit e gjelbërimit të qytetit, të mirëmbajtjes së shkollave e kopshteve dhe të mirëmbajtjes së rrugëve. Sipas planifikimit, nga këto shpenzime: 44,000 ,000 lekë për subvencion klubi i futbollit, 20,000 ,000 lekë shkojnë për shpronësime ku pjesën më të madhe e zënë shpronësimi i objekteve nga ndërtimi i rrugëve, 5,000 ,000 lekë shkojnë për detyrimet gjyqësore që kanë lindur nga marrëdhënie kontraktuale, marrëdhëniet e punës apo shpronësime, 27,100 ,000 lekë janë për mbrojtje dhe emergjenca civile, 1,274 ,000 lekë janë për kuotë anëtarësie shoqata bashkive, 2,000 ,000 lekë për kontributin e qarkut, 7,380 ,000 lekë janë për pagesat e anëtarëve të Këshillit Bashkiak dhe 6,960,000 lekë për Kryetarët e fshatrave, 1,600 ,000 lekë është subvencion transporti urban, qiratë e ambienteve për kopshte dhe për moshën e tretë janë 1,920,000 lekë,

4,000 ,000 lekë për qiratë e të pastrehëve dhe mbrojtjen e fëmijëve, energjia elektrike në masën 45,700 ,000 lekë, uji i pijshëm në masën 4,991,000 lekë, mbështetje projekte kulture e sporti në masën 10,900 ,000 lekë, 40,000,000 lekë janë për materiale për rrugët rurale, 50,000,000 lekë shkojnë për blerje betoni, asfalto betoni e çakull, etj. për shtrimin e rrugëve; 15,104,000 shkojnë për blerje karburanti, 7,600,000 lekë shkojnë në formën e ndihmave ekonomike për familjet në nevojë, 12,650 ,000 lekë janë për ushqimet në kopshte, çerdhe dhe PAK, 57,870 ,000 lekë shkojnë për detyrimet e prapambetura fatura te dhjetorit që do të kalohen në janar etj. , dhe pjesa tjetër është e planifikuar për blerje e shpenzime të paparashikuar në zërat e mësipërm.

Nëse duhet informacion më i detajuar për këtë kategori shpenzimesh pas kërkesës së paraqitur nga ju ,çdo njësi shpenzuese mund të sjellë informacion të detajuar .

2. **Shpenzime për investime**

Shpenzime për investime në buxhetin e vitit 2023 bashkë me ndryshimet zënë 19 % të totalit.

Ashtu si dhe në vitet 2016 - 2022, edhe për vitin 2023, 40% e transfertës së pakushtëzuar është planifikuar dhe përdorur për investime publike, në mënyrë që të kenë mbështetje të sigurt për kryerjen dhe likuidimin e tyre.

Për vitin 2023 kemi një realizim investimesh në masën 189,230,000 lekë nga 318,839,000 lekë të planifikuar ose 53.8%. Përqindja e ulët e realizimit vjen si rezultat i investimeve të reja dhe shumë prej tyre nuk u mundësuan të mbylleshin brenda vitit 2023. Fondet e disponueshme pothuajse shumica nga kapitulli 01 (grandi) u trashëgua në vitin 2024.

Për kontratat e reja të lidhura është bërë depozitimi në Degën e Thesarit brenda 3 ditëve pune siç kërkohet dhe në legjislacionin e buxhetit.

Realizimi i investimeve sipas njësive shpenzuese është:

në '000 lekë

Nr.	INSTITUCIONI	Plani Vjetor 2023	INVESTIME		%
			PLAN	FAKT	
1	Bashkia	**259,886**	259,886	139,851	*53.8*
2	Ndërmarrja P.Publike	**45,865**	45,865	40,685	*88.7*
3	Qendra Kult.& Klubi Sportit	**1,000**	1,000	504	*50.4*
4	Qendra Arsimit	**12,088**	12,088	8,189	*67.7*
	Gjithsej	**318,839**	**318,839**	**189,230**	***59.3***

Në total sa u analizua më sipër realizimi i shpenzimeve sipas ndërmarrjeve të varësisë paraqitet:

për vitin 2023 në shpenzimet e planifikuara dhe të kryera sipas njësive shpenzuese, bashkia zë 40% të totalit të shpenzimeve ose 670,425,000 lekë, Ndërmarrja e Pasurisë Publike zë 33 % të totalit të shpenzimeve të planifikuara ose 543,666,000 lekë, Qendra Kulturore dhe Klubi i sportit zë 6% ose 99,998,000 lekë dhe Qendra e Arsimit zë 21 % ose 353,100,000 lekë të totalit të shpenzimeve.

Realizimi total i shpenzimeve është 1,213,076,000 lekë nga 1,667,190,000 lekë të planifikuara ose 72.8%.

në '000 lekë


Nr.	Institucioni	Plani Vjetor 2023	Totali i shpenzimeve		%
			Plan	Fakt	
1	Bashkia	**670,425**	670,425	427,573	*63.8*
2	Ndërmarrja P.Publike	**543,666**	543,666	363,155	*66.8*
3	Qendra Kult.& Klubi Sportit	**55,998**	55,998	52,087	*93.0*
4	Subvencione futbolli	**44,000**	44,000	43,925	*99.8*
5	Qendra Arsimit	**353,100**	353,100	326,336	*92.4*
	Gjithsej	**1,667,190**	**1,667,190**	**1,213,076**	***72.8***

Buxheti i vitit 2023 është i planifikuar me 23 programe nga 12 programe që ka qenë në vitin 2018 dhe ndjekja e tij bëhet sipas destinacionit të burimeve (grant-01, të ardhura -05, të ardhura jashtë limitit-06 (Kapitull: 01; 05; 06) etj., dhe për çdo njësi shpenzuese. Realizimi i shpenzimeve për vitin 2023 sipas këtyre programeve, jepet sipas tabelës së mëposhtme:

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2023 sipas programeve: në '000 lekë

Nr.	Emërtimi i programit	Plani Vjetor 2023	Realizimi 2023		%
			Plani vjetor	Fakti	
1	Planifikimi ,menaxhimi &Administrimi	247,484	247,484	204,082	*82.2*
2	Shërbimet e policisë vendore 03140	16,560	16,560	13,185	*79.6*
3	Mbrojtja nga zjarri & mbr.civile 03280	24,562	24,562	19,599	*79.8*
3.1	Mbrojtja dhe emergjenca civile	27,100	27,100	1,670	*6.2*

4	Bujqësia 04220	65,335	65,335	47,319	*72.4*
5	Menaxhimi ujitjes dhe kullimit	64,955	64,955	49,209	*75.8*
6	Menaxhimi pyjeve dhe kullota:t04260	1,973	1,973	1,537	*77.9*
7	Rrjeti rrugor 04520	363,929	363,929	211,280	*58.1*
8	Transporti publik 04570-603	1,600	1,600	-	-
9	Programet e mbrojtjes se mjedisit 5320+5100	129,332	129,332	100,205	*77.5*
10	Shërbimet publike vendore(np)	168,011	168,011	113,909	*67.8*
11	Shërbime te kujdesit paresor -07220	5,835	5,835	5,835	*100*
12	Sport dhe argetim 8130 invsest	51,718	51,718	15,991	*30.9*
12.1	Sport dhe argëtim -Futbolli 8140	48,478	48,478	43,925	*90.6*
13	Art dhe kulture 8220	43,485	43,485	40,719	*93.6*
14	Arsimi baze dhe parashkollor+cerdhe 9120	352,478	352,478	308,313	*87.5*
15	Arsimi i mesëm i përgjithshëm -09230	13,238	13,238	13,053	*98.6*
16	Arsimi profesional	11,628	11,628	6,072	*52.2*
17	Kujdesi social për PAK 10140-06	14,760	14,760	12,223	*82.8*
18	Sigurimi shoqëror (Te moshuarit) 10220	1,920	1,920	772	*40.2*
19	Strehimi social 10661	4,150	4,150	2,838	*68.4*
20	Fondi. Rezervë 04910-604	5,660	5,660	1,340	*23.7*
21	Fondi i kontigjencës 04940-604	3,000	3,000	-	-
	Shuma.....	**1,667,190**	**1,667,190**	**1,213,076**	**72.8**



Krahas realizimit total sipas programeve, shpenzimet janë ndjekur nga çdo njësi shpenzuese në mënyrë analitike dhe sipas klasifikimit buxhetor, sikurse janë përcaktuar edhe në buxhetin vjetor.

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2023 janë në masën 72.8 % ose 1,213,076,000 lekë nga 1,667,190,000 lekë të planifikuara. Kjo masë realizimi është e lidhur ngushtë edhe me realizimin e të ardhurave gjithsej të bashkisë, me kohën e kryerjes së investimeve si dhe nga faktorë të tjerë.

Investimet janë të analizuara me programe të veçanta dhe duke qenë se kontratat janë të regjistruara në sistemin e thesarit, gjatë likuidimit ruhet burimi i të ardhurave sipas specifikimeve të kryera në kontratë. Fakti që në buxhetin e vitit planifikohet 40 % e transfertës së pakushtëzuar për investimeve, ka bërë që gjatë vitit 2023 te mos kemi rritje të detyrimeve ndaj investitorëve për këtë grup shpenzimesh. Realizimi i shpenzimeve sipas përqindjes së mësipërme është i ndarë dhe sipas programeve të planifikuara në buxhet.

Realizimi i shpenzimeve sipas përqindjes për disa nga programet është: Arsimi i Bazë me 87%, Arsimi mesëm i përgjithshëm me 99%, Shërbimet publike vendore me 68%, Shërbimi i Zjarrfikëses 80%, Menaxhimi i Ujitjes dhe Kullimit me 76%, Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi me 82%, Sport dhe Argëtim me 31% (theksoj këtu që është plani i investimit të fushës së futbollit prandaj programi ka këtë nivel realizimi. Në vetvete pa investimin ky program është realizuar pothuajse 90%), klubi i futbollit me 91%, kujdesi social PAK me 83%, Strehimi social me 68%, programi i Rrjetit Rrugor i cili ka realizimin 58%, etj.

Nisur nga fondet që alokohen sipas çdo programi, programi "Arsimi bazë dhe parashkollor" ka vlerën 352,478 ,000 lekë ose 21.1% të totalit të shpenzimeve, programi "Rrjeti rrugor" me 363,929 ,000 lekë ose 21.8 % të totalit të shpenzimeve, programi "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi" me 247,484 ,000 lekë ose 14.8 % të totalit të shpenzimeve. Ndikim në realizimin e shpenzimeve sipas programeve japin të gjithë realizimet e zërave të shpenzimeve si paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, shpenzimet operative dhe shpenzimet për investime, realizimi i të cilave është pasqyruar më sipër. Realizimi i këtyre zërave të programeve është domosdoshmërish i lidhur edhe me realizimin e të ardhurave vendore. Mos realizimi i tyre në nivelin e planifikuar ndikon negativisht edhe në shtimin e detyrimeve.

Pjesë e këtyre shpenzimeve është dhe përdorimi i Fondit rezervë i cili ishte i planifikuar 7 000,000 lekë që është realizuar në masën 23.7 % ose 1 340,000 lekë. Këto fonde janë përdorur me vendime të Këshillit Bashkiak. Fondi i kontigjencës është gjendje në masën 3,000,000 lekë. Hollësi të mëtejshme lidhur me aktivitetin e tyre dhe realizimin e detyrave mund të japë çdo njësi shpenzuese me kërkesën e paraqitur edhe nga Këshilli Bashkiak.

Për çdo fillim muaji me Degën e Thesarit Lushnje, bëhen rakordimet përkatëse si për të ardhurat ashtu edhe për shpenzimet. Gjendja që mbetet trashëgohet për vitin pasardhës. Dhe nga viti 2023, për në vitin 2024 u trashëguan 362,366,000 lekë të ardhura, nga të cilat një pjesë është pjesë e buxhetit të vitit 2024 dhe pjesa tjetër është një e ardhur plus dhe një lehtësim në drejtim të likuidimit të detyrimeve të prapambetura. Për vlerën mbi kufirin e planifikuar për vitin 2024 do paraqesim material në Këshillin Bashkiak për programet e përdorimit. Detyrimet e prapambetura deri në fund të vitit 2023 janë 42,905,000 lekë.

Nisur nga përcaktimet që jep edhe Udhëzimi nr. 26, datë 27.9.2019 "Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore", bashkia ndodhet në një situatë të mirë financiare kur bashkitë me problemeve financiare kanë një kufi deri 15-20% të shpenzimeve vjetore të miratuara në buxhet.

Në mënyrë të përmbledhur **realizimi i treguesve financiarë për vitin 2023** janë sipas tabelës në vazhdim:

Nr.	TREGUESIT FINANCIARË	Fakti v. 2023
	Shpenzimet e përgjithshme	1,213,076,322
	Të ardhurat e përgjithshme	1,575,442,716.74
1	**Raporti ne %**	**77.0**

	Të ardhurat e veta vendore	690,991,948.74
	Të ardhura të përgjithshme	1,575,442,717
2	**Raporti ne %**	**43.9**
	Shpenzimet kapitale	189,229,512
	Shpenzimet e përgjithshme	1,213,076,322
3	**Raporti ne %**	**15.6**
	Shpenzimet e personelit	694,616,200
	Shpenzimet e përgjithshme	1,213,076,322
4	**Raporti ne %**	**57**
	Detyrime tatimore të pa arkëtuara në kohë	131,035,551
	Të ardhura tatimore (Të ardhurat e veta-plan)	613,300,000
5	**Raporti ne %**	**21**
	Shpenzimet për politikat e kujdesit social	28,681,010
	Shpenzimet e përgjithshme	1,213,076,322
6	**Raporti ne %**	**2.4**
	Detyrimet financiare të pa paguara në kohë	42,905,587
	Të ardhura të përgjithshme (plan 2023)	1,667,190,268
7	**Raporti ne %**	**2.57**

Hollësi të mëtejshme lidhur me aktivitetin e tyre dhe realizimin e detyrave mund të japë çdo njësi shpenzuese.

Donald NUSHI

DREJTORI
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

Juljana HASALLA

DREJTORE
DREJTORIA E FINANCËS dhe BUXHETIT